

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI

Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA

Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7617 E shtunë 11 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje

në Radio Evropa e Lirë

Nga ARTON KONUSHEVCI

Nga teknike, në bisedime për ndryshim kufijsh



Opinion

i Ditës

Nga BATON HAXHIU

Thaçi-Vuçiç/Çka nëse ia dalin?

Ndarjet janë gjithmonë të vështira. Veçanërisht ato territoriale. Disa janë të thjeshta për t'u kuptuar, si e Kosovës nga Serbia në vitin 1999, por disa tjera janë shumë...

Vijon në faqet 20-21

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ai i Serbisë, Aleksandar Vuçiç janë të një pajtimi që kufijtë e Kosovës duhet të ndryshojnë. Por, ata duan vetëm të marrin...


Vijon në faqet 21

NGJARJA NE SELENICE, I RIU VRET ME KALLASH 8 VETA NGA I NJEJTI FIS

HORROR NE VLORE, SHUHEN DY FAMILJE DHE DY FEMIJE

• Kush është Ridvan Zykaj dhe përplasjet nëse është psikik

• Autori në "Facebook": Unë s'u bie në qafë kushërinjve, po më ngacmuan, atëherë...



(Në foto) Autori i masakrës, Ridvan Zykaj. Policia në fshatin Resulaj ku ndodhi masakra

VLORE
Tronditet Vloja. Tetë persona, pjesëtarë të dy familjeve të të njëjtit fis janë vrrarë sa hap e mbyll sytë në fshatin Resulaj të Selenicës, duke shënuar kështu një masakër që ka shokuar jo vetëm banorët e zonës, por të gjithë opinionin publik. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së qarkut të Vlorës...



DYSHIMET E HISTORIA

Ekzekutohet kunati i të "fortit" të Shkodrës, Lulzim Kulla, çfarë e tha atentatori

Në faqet 3

SPEKTAKLI I MADH

Mijëra veta e gahijnë në shesh me "Birra Korça", qyteti 'mësyhet' nga turistët europianë

Në faqet 7

MEDIAT: PLAN HAKMARRJEJE

Kërcënohet me jetë ministri shqiptar, Majko: S'kam frikë. SHBA: Rrit sigurinë

Në faqet 5

"BLUETOOTH", THASHETHEME

Pas lindjes së të voglës, flet Garo: 'Projektet e mia'. VIP-a në plazh, çfarë ndodh

Suplement

Përfituesit e kështjës parë dhe të dytë, dokumentet në Drejtorinë e Pagesave

Ish-të përndjekurit, 650 trashëgimtarët marrin paratë

Ish-të dënuarit politikë dhe 200 përfituesit e dëmshpërblimit. Gati pagesat, dokumenti duhet dorëzuar brenda 30 ditëve

Në faqet 10-12



HORROR NE VLORE E SHKODER SI NDODHEN NGJARJET

Banorët: Ishte nevrík. Policia në kërkim të vrasësit: Është person i rrezikshëm!

Masakër në Vlorë, i riu vret me automatik 8 persona, shuan 2 familje

24-vjeçari Rivan Zykaj dyshohet të ketë qenë i dehur. Mes viktimave, 3 gra dhe 2 fëmijë

VLORE

Tronditet Vloja. Tetë persona, pjesëtarë të dy familjeve të të njëjtit fis janë vrarë sa hap e mbyll sytë në fshatin Resulaj të Selenicës, duke shënuar kështu një masakër që ka shokuar jo vetëm banorët e zonës, por të gjithë opinionin publik. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së qarkut të Vlorës bënë me dije se dy nga viktimat janë fëmijë, të moshës 16 dhe 8 vjeç. Mësohet se autor i ngjarjes së rëndë të ndodhur pasditen e djeshme është 24-vjeçari Ridvan Zykaj, i cili dyshohet se vuan nga probleme mendore. Sipas burimeve policore, i riu ka qëlluar me breshëri automatiku të afërmit e tij (kushërinj e parë të babait), ndërsa ka përdorur thuasje 2 karikatorë, duke vrarë në pak minuta tetë persona. Pak pas masakrës, ai është larguar nga vendi i ngjarjes, ndërsa forca të shumta të policisë, RENEJA, DELTA FORCE dhe FNNSH kanë rrethuar fshatin si dhe janë vënë në ndjekje të tij. Po ashtu, në vendin e ngjarjes kanë shkuar edhe katër autoambulanca, të cilat kanë transportuar trupat e pajetë drejt morgut të Vlorës. Ende nuk është i qartë shkaku që shtyu 24-vjeçarin që të ekzekutoonte tetë anëtarët e fisit të tij. Ndërkohë, policia ka bërë apel për ndihmë për gjetjen dhe kapjen e autorit të masakrës, të cilin e cilëson si person me rrezikshmëri të lartë.

MASAKRA

Pasditen e djeshme është shënuar ngjarja më e rëndë kriminale në vendin tonë. Sipas burimeve policore, viktimat janë Azem Zykaj, 45 vjeç; Aferdita Zykaj, 42 vjeç; Demir Zykaj, 75 vjeç; Perie Zykaj, 72 vjeç; Besim Zykaj, 43 vjeç; Vasilika Zykaj, 42 vjeç; Sara Zykaj,



Autori i masakrës, Ridvan Zykaj

MINISTRI XHAFAJ

Ngjarja e rëndë që tronditi Vlorën dhe jo vetëm, me një bilanç prej 8 viktimash, ka bërë që ministri i Brendshëm, Fahir Xhafaj të nisët me urgjencë drejt vendit të krimit në fshatin Resulaj. Burime për "GSH" pohuan se Xhafaj është shoqëruar nga drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu.

**Autori i masakrës në "Facebook":
Unë s'u bie në qafë kushërinjve,
po më ngacmuan, atëherë...**

Ridvan Zykaj ishte i papunë, ndërsa më herët kishte qenë i shtruar për disa muaj në spitalin psikiatrik të Vlorës, për shkak të problemeve mendore. Ndërkohë, në profilin e tij në "Facebook" i riu përveç fotove që ka postuar, shihet se ka pasion edhe poezitë, shumë prej të cilave të dhunshme dhe me urretje. Në pjesën e komentëve një i afërm e këshillonte Ridvanin para dy viteve të mos konfliktohej me kushërinjtë, sidomos në "Facebook". Por ai pasi e falënderonte për këshillën "xhaxhanë", i kujtonte atij se "unë kot s'u bie në qafë, por kam një gjë, po më ngacmuan, atëherë s'i lë rehat. Unë s'kam ç'bëj, por ja që e kam këtë gjë".

16 vjeç; Ledion Zykaj, 8 vjeç. Po të njëjtat burime pohuan se i riu Ridvan Zykaj ka vrarë të afërmit e tij: Demir Zykajn (vëllai i gjyshit të tij) dhe gruan e tij si dhe dy djemjtë e çiftit.

Gjithashtu, ai ka ekzekutuar djalin e Demirit, Azemin dhe gruan e tij si dhe djalin tjetër të Demirit, Besimin dhe gruan e tij si dhe dy fëmijët e tyre, Sarën dhe Ledjonin. Prindërit e autorit të


BANORËT

Skena horror (tetë kufomat e mbuluar me çarçafë) ka shokuar banorët e fshatit Resulaj, të cilët thanë për "GSH" se 24-vjeçari ishte pak nevrík. "Ne e dimë se ai ishte nevrík, por nuk dimë të ketë qenë me të meta mendore. Nuk kishte as probleme me alkoolin. I ka kushërinjtë e parë të babait ata që ka vrarë.

DËSHMIA

Një afërm i viktimave tha se nuk ka dëgjuar për probleme mes autorit dhe viktimave. "Kanë pasur marrëdhënie të mira, kanë qenë kushërinj me njëri-tjetrin. Mund të ketë qenë ndonjë konflikt i rastit, apo ndonjë depresion i autorit. Ka qenë një herë i sëmurë ky djali, ka pasur djegie në 75 për qind të trupit, u kurua dhe erdhi. Ka pasur sjellje të mirë, njerëz të mirë, njerëz të nderuar nga të gjithë".

masakrës janë shoqëruar në polici dhe janë marrë në pyetje në lidhje me rrethanat e ngjarjes. Mësohet se pak para ngjarjes Ridvan Zykaj ishte në një drekë me familjen. Dyshohet se ai në momentin që ka kryer vrasjet ka qenë në gjendje të dehur. Gjithashtu, mësohet se i riu kishte zënka të vazhdueshme me të afërmit e tij për motive të dobëta, megjithatë nuk përjashtohet pista e konfliktit për pronë. Pas ngjarjes, fqinjët e viktimave u shprehën se autori i masakrës ishte nevrík.



Fshati Resulaj ku ndodhi masakra

VIKTAMAT E MASAKRËS NË VLORE

1. Demir Zykaj, 75 vjeç (vëllai i gjyshit të autorit).
2. Perie Zykaj, 72 vjeç, (gruaja e Demirit).
3. Besim Zykaj, 43 vjeç (djali i Demirit).
4. Vasilika Zykaj, 42 vjeç (gruaja e Besimit).
5. Sara Zykaj, 16 vjeç (vajza e Besimit).
6. Ledjon Zykaj, 8 vjeç (djali i Besimit).
7. Azem Zykaj, 45 vjeç (djali i Demirit).
8. Aferdita Zykaj, 42 vjeç (gruaja e Azemit).

Ish-deputeti Dokle: Tragjedi e madhe, ja çfarë duhet të bëjë

Në lidhje me masakrën e ndodhur pasditen e djeshme në Vlorë ka reaguar dhe ish-deputeti socialist, Namik Dokle. Në një status në "Facebook", ai shprehet se është tragjedi e madhe, ndërsa thotë se çfarë duhet të bëjë.

STATUSET I PLOTË

Lajm tronditës! Masakër me tetë të vrarë. Tragjedi e madhe në familjet e tyre. Dhimbeje e pakufi për viktimat. Çfarë duhet të bëjë pas kësaj?

1. Mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit.
2. Ligj i veçantë kundër armëmbajtjes pa leje, me dënim fiks, që të mos mundet asnjë gjyqtar (i "vetëinguar" apo i "pavetëinguar") të bëjë "politikë gjyqësore" korruptive.
3. Shpërblim për çdo qytetar denoncues të krimit të armëmbajtjes pa leje.
4. Aksion policor dhe qytetar për dorëzimin e armëve pa leje dhe kufizim i atyre me leje.

TË GJITHË BASHKË TË SHPËTOJMË JETË!

POLICIA

Vrasja e tetë personave në fshatin Resulaj ka alarmuar policinë e Vlorës, e cila në bashkëpunim me forcat speciale po punon intensivisht për gjetjen dhe kapjen e ekzekutorit, Ridvan Zykajn, i cili pohohet se ka qenë më parë i shtruar në spitalin psikiatrik të Vlorës. Autori është ende në gjendje të lirë dhe i armatosur, ndërkohë që vijojnë kontrollet nga toka, ajri dhe deti. RENEJA dhe FNNSH i është urdhëruar që t'i përgjigjen me zjarr 24-

vjeçarit, i cili është një rrezik permanent edhe për jetën e efektivëve. Policia e Vlorës ka kërkuar ndihmën e qytetarëve për identifikimin sa më shpejt të vendndodhjes së autorit të krimit dhe fton ata që të telefonojnë në numrin: 069 41 10 242 si dhe në numrin pa pagesë 129, duke iu garantuar anonimitetin. Policia e Vlorës sqaron se autori është i rrezikshëm dhe në rast konstatimi, ti shmangen përballjes me të, por të telefonojnë policinë.

Shoqërohen 15 persona. Dysohet për gjakmarrje, viktima u akuzua për një vrasje në 2011-ën

Ekzekutohet me 15 plumba automatiku kunati i të "fortit" të Shkodrës, Lulzim Kulla

Fatbardh Lici u qëllua nga një person i maskuar në lokal. Atentatori: Ke të fala. Dogji makinën në fshatin Dobraq



MESAZHI I ATENTATORIT
Mustafa Lici ka qenë i vetëm në tavolinën kur po pinte kafën e mëngjesit, kur një person i maskuar është afruar deri rreth 20 metër larg vendit ku ndodhej ai. Atentatori para se ta qëllonte 53-vjeçarin me automatik tip "scorpion" mësohet t'i ketë thënë viktimës: "Të fala". Të paktën kështu mësohet të jetë shprehur njëri prej dëshmitarëve në vendngjarje. Breshëria e madhe e plumbave në drejtim të tij rezultoi fatale, pasi nga të shtënat 53-vjeçari mbeti i vdekur në vend.

SHKODËR
Një 53-vjeçar është ekzekutuar me breshëri automatiku në Shkodër. Fatbardh Lici është qëlluar për vdekje me 15 plumba dhe për pasojë ka gjetur vdekjen e menjëhershme. Ngjarja e rëndë, e cila tronditi banorët e qytetit verior ndodhi në orët e para të mëngjesit të djeshëm në lagjen "Guerrile", ose në vendin e njohur si ish-Poçeria. Mësohet se Fatbardh Lici, baba i tre fëmijëve (dy djemve dhe një vajze) ishte duke pirë kafën e mëngjesit në një prej lokaleve të zonës në fjalë, pak metra larg banesës së tij kur një person i maskuar ka qëlluar me breshëri drejt tij, duke mos i lënë mundësi shpëtimi. Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar policia, e cila ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes. Ndërkohë, pas atentatit autori i krimit është larguar me shpejtësi dhe ka djegur makinën në fshatin Dobraq. Grupi hetimor është duke hetuar në disa pista, por kryesorja është ajo e hakmarrjes. Kjo për faktin se viktima është akuzuar si autor i vrasjes së Astrit Kurmemaj, ngjarje kjo e ndodhur 7 vite më parë. Gjithashtu, Fatbardh Lici është kunati i biznesmenit Lulzim Kulla, i njohur si i 'forti' i Shkodrës, ndaj të cilit u krye një atentat me minë me telekomandë në Shkodër. Por sipas policisë, nuk ka të dhëna që ngjarjet të kenë lidhje me njëra-tjetrën.



53-vjeçari i vrarë, Fatbardh Lici



Vendi ku ndodhi vrasja

Zanafilla e vrasjeve në Shkodër/ Ekzekutimi i misionarit të pajtimit dhe gjakmarrja mes familjeve

SHKODËR - Fatbardh Lici, i cili u ekzekutua mëngjesin e djeshëm në Shkodër dyshohet se ka qenë i përfshirë në vrasjen e Astrit Kurmemaj. Ngjarje kjo e ndodhur më 15 mars të vitit 2011. Pas ekzekutimit të 45-vjeçarit që ishte dënua për një vrasje tjetër, u shoqërua si i dyshuar Fatbardh Lici. Astrit Kurmemaj u vra pranë shtëpisë së tij në një rrugicë të lagjes "Kiras" në Shkodër, teksa kishte dalë me leje nga burgu dhe po kthehej në institucionin e vuajtjes së dënimit. Pista kryesore e hetimeve për vrasjen e djeshme në Shkodër mbetet gjakmarrja mes dy familjeve Kurmemaj dhe Lici. 45-vjeçari Kurmemaj ishte përfshirë në dy vrasje: e para në atë të Genc Muçës, për të cilën mori pafajësinë dhe ajo e kushëririt të viktimit, Luan Muça, për të cilën po kryente dënimin me 14 vjet burg. Ka qenë ora rreth 15:30 e 15 marsit, kur në një rrugicë dytësore të lagjes periferike të qytetit të Shkodrës, rreth 500 metra



larg shtëpisë së viktimës, Astrit Kurmemaj është qëlluar me një plumb pas koke. Viktima ka qenë duke ecur vetëm në këmbë dhe në kokë mbante një kapelë, si dhe një palë syze të mëdha dielli, për të mos u njohur nga kalimtarët e rastësishëm, gjithmonë duke u ruajtur nga frika e hakmarrjes. Për policinë, nuk ka pasur asnjë dyshim se krimi ka pasur si shkak gjakmarrjen, duke e lidhur me ngjarjet me familjen Muça. Në vitin 1998 u vra Genc Muça, ndërsa në vitin 2002 Besnik Kurmemaj. Ekzekutimet vazhduan në vitin 2003 me Luan Muçën dhe më pas me Astrit Kurmemajn në 2011.

VRASJA E MISIONARIT TË PAJTIMIT

Emri i Astrit Kurmemaj u nxor nga policia e Shkodrës në gusht të vitit 2004, pas ekzekutimit të kryemisionarit të pajtimit, Emin Spahija. Policia e cilësoi Kurmemajn, në atë kohë në kërkim, si person të dyshuar. Spahija rezultoi se kishte ndërruar mes dy familjeve Kurmemaj dhe Muça për t'u pajtuar pas vrasjes së Genc Muçës. Me gjithë variantin e policisë, nuk u gjetën prova dhe familja e viktimit Spahija pohoi se nuk kishte asnjë dyshim mbi Kurmemajn. Krimi ndaj Spahisë, kryer para shtëpisë së tij në Shkodër ka mbetur mister.

vat e mundshme në vendin e ngjarjes. Sipas burimeve janë 15 plumba, me të cilët është qëlluar viktima. Në momentin e vrasjes, në lokalin ku ndodhi ngjarja ka pasur një numër të paktë personash. Po ashtu nuk ka pasur kalimtarë të rastit për shkak të orarit kur ndodhur vrasja.

HETIMET

Policia ende nuk ka një pistë konkrete pas vrasjes së ndodhur në lagjen "Guerrile", ku gjeti vdekjen e menjëhershme 53-vjeçari Fatbardh Lici. Megjithatë, ka disa dyshime momentale për efektivet. Dyshimet kryesore për vrasjen e Fatbardh Licit janë për gjakmarrje, edhe pse kjo mbetet në kuadrin e dyshimeve. Policia pas vrasjes së babait të tre fëmijëve ka rrethuar shtëpinë në të cilën ka jetuar më përpara Astrit Kurmemaj. Ky i fundit është vrarë në vitin 2011 në Shkodër. Policia në atë kohë dyshoi se mund të kishte lidhje Fatbardh Lici, por pas shoqërimit të këtij të fundit, u la sërish i lirë duke mos u dënua për shkak se nuk kishte asnjë provë ndaj tij. Ndërkaq, policia po heton edhe në pista të tjera për vrasjen e Fatbardh Licit, që mund të jetë ndonjë hakmarrje ndaj tij për shkak të konflikteve të mëparshme me persona që mund të kenë lidhje me familjen Lici, ky i fundit anëtar në Këshillin Bashkiak të Shkodrës me partinë Mendimi Liberal. Pjesa më e madhe dëshmitarë ose persona që mund të kenë dijeni për ngjarjen e ndodhur, por deri më tani nuk ka asnjë konkrete. Policia po punon për zbardhjen kësaj vrasjeje të ndodhur në Shkodër. Fatbardh Lici është vëllai i Mustafa Licit, ky i fundit anëtar në Këshillin Bashkiak të Shkodrës me partinë Mendimi Liberal.

15

PERSONA
Pas vrasjes në atentat të 53-vjeçarit Fatbardh Lici, policia ka shoqëruar dhe marrë në pyetje 15 persona. Mësohet se pjesa më e madhe e të shoqëruarve janë dëshmitarë ose persona që mund të kenë dijeni për ngjarjen e ndodhur, por deri më tani nuk ka asnjë konkrete. Viktima ishte babai i tre fëmijëve, dy djemve dhe një vajze. Familja Lici ka hapur dyert e morit, ndërsa 53-vjeçari është përcjellë në banesën e fundit dje në orën 19:00.

KUSH ËSHTË VIKTIMA
53-vjeçari Fatbardh Lici është vëllai i Mustafa Licit, anëtar i Këshillit Bashkiak të Shkodrës dhe kryetar i partisë Mendimi i Djathtë Liberal, si dhe kunati i biznesmenit Lulzim Kulla, (burri i motrës), i cili aktualisht ndodhet në burg. Kulla u arrestua pak ditë më parë në Kakavijë, pasi tentoi të kalonte në Greqi me një pasaportë të falsifikuar. Ndaj Kullës pak muaj më parë u bë një atentat me eksploziv ku mbeti i plagosur.

segmentin e parikonstruktuar ka ecur rreth 100 metra duke marrë kthesën në atë zonë në një rrugicë dytësore. Më pas ka ndalur mjedin dhe ka dalë jashtë. Menjëherë agresori i ka vënë flakën për të humbur çdo lloj

gjurmë të mundshme të krimit. Sipas burimeve të mësipërme, mjedi është djegur tërësisht, duke mos lënë asnjë shenjë brenda apo jashtë tij. Pas vrasjes së ndodhur në lagjen "Guerrile", menjëherë në vendngjarje kanë mbërritur forcat e policisë dhe një ambulancë e spitalit rajonal të Shkodrës. Ka qenë e pamundur për t'i dhënë ndihmën e parë, sepse 53-vjeçari ka gjetur vdekjen e menjëhershme. Efektivët kanë mbledhur të gjitha pro-

KUFIRI KOSOVE-SERBI REAGIMET

Ish-kryeministri i Suedisë, Carl Bildt: Rama, i hapur për idetë e Vuçiç dhe Thaçit

Rishikimi i kufijve/ KE: Zgjidhja duhet të jetë realiste dhe e mundshme

Kërcënon Daçiç: Mos luani me nervat dhe muskujt e Serbisë

Darina Tanushi

Komisioni Evropian ka reaguar lidhur me tezën e shumë diskutuar të ditëve të fundit, atë të rishikimit të kufijve midis Kosovës e Serbisë. "Një zgjidhje e përhershme nënkupton një zgjidhje realiste, e qëndrueshme dhe e mundshme, në pajtueshmëri me të drejtën ndërkombëtare e mbi të cilën Prishtina dhe Beogradi duhet të kenë pajtueshmëri", ka deklaruar dje në Bruksel zëdhënësi i Komisionit Evropian, Carlos Martin. I pyetur nëse Komisioni Evropian mbështet qëndrimin e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiç, për ndarje ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë, ai ka thënë se gjatë takimit të nivelit të lartë, Vuçiç dhe Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kanë pasur "bisedime intensive dhe produktive mbi kornizën e marrëveshjes për normalizimin e plotë të marrëdhënieve dhe se janë pajtuar për intensifikimin e punëve". Martin ka shtuar gjithashtu se më 18 korrik, "Vuçiç dhe Thaçi kanë shqyrtuar përparimin e arritur dhe janë pajtuar të takohen sërisht në fillim të shtatorit". "Dialogu i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian ka për synim nxitjen e arritjes së një bashkëpunimi të përhershëm mes të dyja palëve dhe t'i ndihmojë atyre të arrijnë përparim në rrugën e tyre drejt Evropës", ka thënë Martin. Ndërkaq, Carl Bildt, ish-kryeministër i Suedisë tregon për herë të parë qëndrimin e kryeministrit Rama për çështjen e kufijve të Kosovës. Sipas Bildt, Rama është i hapur për idetë e Vuçiç dhe Thaçit për korrigjimin e kufijve. Por Bildt paralajmëron të njëjtin skenar edhe për Maqedoninë, ku ka popullsi dërrmuese shqiptare, çka sipas tij do të ishte një lloj sikur të luaje me zjarrin.



Berisha: Rama rrezik për kombin shqiptar, ra dakord me Vuçiç

Ish-kryeministri Sali Berisha thotë se kryeministri Edi Rama ka rënë dakord me presidentin serb, Aleksandar Vuçiç për ndarjen e Kosovës. Në një status në "Facebook", Berisha nuk heq dorë së quajtur Ramën "Jorgo Kristaq Zografi i dytë" dhe e quan një rrezik për kombin shqiptar atë dhe albanofobët e tjerë shqiptarë. Berisha sjell shkrimin e ish-kryeministrit të Suedisë, Carl Bildt për "Washington Post", ku tregon se edhe kryeministri Edi Rama ishte i hapur për idenë e Vuçiç për kalimin në Serbi të pjesës veriore të Mitrovicës. Ish-kryeministri thotë se trojet shqiptare janë në prag të një copëtimi të dytë, por kësaj radhe jo nga fuqitë e mëdha, por nga shqiptarët albanofobë. "Të dashur miq, sot trojet shqiptare për shkak të kapitullimit të Jorgo Kristaq Zografit të dytë dhe argatëve të Beogradit në Prishtinë janë në prag të një copëtimi të dytë, por kësaj radhe jo nga fuqitë e mëdha, por nga shqiptarët albanofobë, që aktualisht janë një rrezik i jashtëzakonshëm për kombin shqiptar", u shpreh Berisha.



edhe disa lokalitete, kryesisht të banuara në Serbinë Jugore. Dhe pastaj ekziston çështja edhe më e vështirë dhe e rrezikshme e Maqedonisë, ku shqiptarët janë pjesë e konsiderueshme të popullsisë. Do të ketë patjetër nga ata që pyesin pse kjo nuk duhet të zbatohet edhe në Maqedoni. Kjo do të ishte seriozisht të luaje me zjarrin", tha Bildt.

SERBIA E RUSIA
Kryediplomati serb, Ivica Daçiç mbështet tezën e rish-

ikimit të kufijve me Kosovën, ndërsa ka hedhur akuza të ashpër në drejtim të ndërkombehtarëve. Deklaratat e forta Daçiç i ka bërë gjatë takimit me zëdhënësen e Ministrisë së Jashtme ruse, Maria Zaharova, e cila ka vizituar Beogradin ditën e djeshme. Daçiç tha se perëndimi hapi "kutinë e Pandorës" që kur bombardoi Serbinë, duke shkatërruar sipas tij, kufijtë. "Ata që kufijtë tanë i shkatërruan, ata të cilët na bombar-

ÇËSHTJA E KUFIJVE

Carl Bildt, ish-kryeministër i Suedisë tregon për herë të parë qëndrimin e kryeministrit Rama për çështjen e kufijve të Kosovës. Sipas Bildt, Rama është i hapur për idetë e Vuçiç dhe Thaçit për korrigjimin e kufijve. Por Bildt paralajmëron të njëjtin skenar edhe për Maqedoninë, ku ka popullsi dërrmuese shqiptare, çka sipas tij do të ishte një lloj sikur të luaje me zjarrin.



Shehu: Ideja e kufijve, pas deklaratave të Majkos, destabilizohet Ballkani

Ish-ministri i Jashtëm, deputeti demokrat Tritan Shehu ka kërkuar që Shqipëria të marrë një rol kyç në çështjen e kufijve dhe të qëndrojë kundër rishikimit të kufijve. Në një analizë të bërë në studion e "News 24", në rubrikën "Opinion", Shehu tha se ideja e ndryshimit të kufijve në Kosovë është e lidhur me Beogradin. Sipas tij, kjo ide nga Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi erdhi pas deklaratave të ministrit të Diasporës, Pandeli Majko, raporton "Balkanëb". "Ky është një proces, i cili nuk do kishte fund dhe do shoqërohet me konflikte të rrezikshme për banorët në këtë gadishull. Kjo iniciativë që përsëri është e lidhur me Beogradin, për mua ka në prapaskenë faktorë që përpiqen të sjellin disa ide të rrezikshme për rajonin që duan të zhvlerësojnë të gjithë atë që u bë me pavarësinë e Kosovës, atë punë heroike që u bë për arrijtjen e Kosovës së lirë. Të japin përshtypjen se duan të çojnë në një Ballkan jo stabil. Unë shoh se kjo ide nuk është e izoluar vetëm në Beograd, por duket që ka një koordinim edhe me Tiranën. E mori zanafillën në një deklaratë të ministrit Majko në emër të kryeministrit në mënyrë të papërshtatshme, në një ambient të papërshtatshëm, duke hedhur një ide të tillë që nga janari kryeministri do rrezojë kufirin Shqipëri-Kosovë."

Majko i përgjigjet deputetit të PD-së: Pse s'është e njëjtë me lëvizjen e lirë

Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko u është bashkuar reagimeve në distancë për ndryshimin e kufijve mes Kosovës dhe Serbisë. Përmes një statusi në "Facebook", Majko tekua i kthente përgjigje deputetit të PD-së, Tritan Shehu se ky debat e mori pikënisjen nga deklaratat e ministrit, theksoi se çështja për "Rrezim të kufirit" është për rastin e embargove. "Tritan Shehu ka deklaruar se ideja për ndryshimin e kufijve e hapur së fundmi... E mori zanafillën në një deklaratë të ministrit Majko... në një ambient të papërshtatshëm duke hedhur një ide të tillë që nga janari kryeministri do rrezojë kufirin Shqipëri-Kosovë. (?) (As serbi Gjuriq nuk e rëndoi kaq shumë këtë deklaratë të pathënë). Të lidhësh dëshirën për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave midis Shqipërisë dhe Kosovës, me temën ndryshimit të kufijve është papërgjegjshmëri. Kjo temë është dakordësuar midis Shqipërisë dhe Kosovës dhe u ripohua sërisht nga kryeministri Haradinaj gjatë vizitës së fundit në Vlorë. "Rrezimi i kufirit" si term përdoret në rastet e embargove... Lëvizja e lirë nuk ndryshon kufijtë. Ndryshimi i kufirit nuk është funksional në kohët e reja të procesit të integritimit evropian. Shqipëria dhe Kosova nuk mund të bëjnë dy gjëra të kundërta në të njëjtën kohë."



Zyrtarët amerikanë e këshilluan ministrin shqiptar të rrisë sigurinë

Kërcënohet me jetë ministri shqiptar, Majko tha për "FOX News": Nuk kam frikë

Media amerikane: Irani planifikon terror në tokën evropiane

Ministri i Diasporës në Shqipëri, Pandeli Majko është kërcënuar dhe gjithçka e kanë zbuluar amerikanët, të cilët i kanë kërkuar të rrisë sigurinë. Lajmi është bërë publik në një artikull të "Fox News" të gazetarëve Ben Evansky e Rich Edson në bashkëpunim me "Associated Press", me titull "Irani planifikon terror në tokën evropiane, ndërsa BE përpigjet të mbrojë regjimin nga shtyrja e sanksioneve të Trump". Në artikull shkruhet se ministri shqiptar i Diasporës, Pandeli Majko, është shprehur për televizionin amerikan se zyrtarët amerikanë i kanë thënë se duhet të rrisë sigurinë pas zbulimit të një kërcënimi kundër tij. Teksa tha se strategjia e Iranit në rajon është "e pashembullt", ai shtoi gjithashtu për "Fox News": "Nuk kam frikë". Duke u ndalur te "fushata e terrorit të Iranit në Evropë", në artikull shkruhet: "Ka edhe shqetësime rreth pranisë së regjimit në Shqipëri, ku disidentët u thanë 'Fox News' se, ambasada iraniane po punon dhe ka dërguar nëpunës të lartë të inteligjencës. Sipas artikullit, Shqipëria është e rëndësishme, sepse ishte vendi ku më shumë se 2.000 disidentë iranianë që i përkisnin Muxhahidit të Popullit të Iranit (MEK) u zhvendosën nga Iraku në 2016. Këshilli Kombëtar i Rezistencës në Iran (NCRI) tha se regjimi donte t'i vriste ata në Irak dhe dëshmtim për ta bërë këtë shënoi një 'pengesë të madhe' për regjimin". Sakaq, një zyrtar i lartë amerikan i antiterrorizmit i konfirmoi "Fox News" se autoritetet shqiptare arrestuan dy iranianë për akuzat e terrorit në fillim të këtij viti. "Irani ka një histori të gjatë përgjatë 39 viteve të fundit të kryerjes dhe planifikimit të vrasjeve dhe veprimeve terroriste kundër kundërshtrareve të regjimit iranian, duke përfshirë një seri vrasjesh dhe sulmesh në vitet e fundit në vendet evropiane", tha zyrtari. Zyrtarët e SHBA-ve nuk janë treguar të ndrojtur në deklaratat lidhur me komplotet terroriste. Sekretari i Shtetit, Mike Pompeo në një fjalim muajin e kaluar, vuri në dukje përpjekjet në Paris, si dëshmi të qëllimeve të regjimit.



Ministri i Diasporës në Shqipëri, Pandeli Majko

PANDELI MAJKO
Vetë ministri i Shtetit për Diasporën ka shmangur komentet për lajmin. I kontaktuar nga media, ai nuk ka pranuar të japë më shumë informacion, duke e lënë në heshtje këtë lajm të publikuar nga media amerikane.

"Kjo ju tregon gjithçka që duhet të dini për regjimin. Në të njëjtën kohë po përpigjet të bindin Evropën për të qëndruar në marrëveshjen bërthamore, ata po planifikojnë fshehurazi sulme terroriste në zemër të Evropës", tha ai. Ndërsa Mo-

hammad Mohaddessin, kryetari i Komitetit të Punëve të Jashtme të Këshillit Kombëtar të Rezistencës së Iranit (NCRI), tha në një deklaratë për "Fox News" se nuk ka dyshim se komplotet vijnë nga udhëheqja e regjimit. "Komplotet e

regjimit iranian në Shqipëri dhe në Paris ishin të ngjashme me operacionet që ISIS kreu për të synuar turmat e mëdha dhe për të shkuar ar dhe në një numër të madh njerëzish në të njëjtën kohë", tha ai në një deklaratë për "Fox News".

"Shpërthen" deputeti i PD: Rama, ideatori për 'shkëmbim terrioresh' të Kosovës, Thaçi masha

Pas deklaratës së presidentit Hashim Thaçi për rregullim kufijsh, vjen një reagim i ashpër nga deputeti i PD-së, Luçiano Boçi, i cili në një status "Facebook" bën akuza të forta ndaj kryeministrit Edi Rama. "Nga provokacioni tek uklanjanje breza. Provokacioni nuk ka nevojë për përthim, pasi është përdorur rëndom. Ndërsa UKLAN-JALE BRE?A fjalë për fjalë do të thotë 'HEQJA E BREKËVE'. Zgjidha përthimin literal në mungesë të shprehjes së duhur frazeologjike. Të dy nocionet janë sjellë për të shënuar pikat ekstreme të një rrugëtimi të turpshëm të kryeministrit më të dështuar shqiptar, në çështjen e Kosovës e jo vetëm. Sot, me gjithë debatin intensiv, lideri rajonal - togfjalësh me të cilin e qesëndiste dhe e miklonte njëkohësisht Vuçiq, po hesh. Po kërkon se e si të qëndrojë larg e të duket duarjashhtë. Ndërkohë po heshit dhe sepe nuk mund të flasë për atë çka vetë ka gatuar dhe që kundërdemon tradhti. E në këtë histori Thaçi duket të jetë vetëm masha, mbajtësi i së cilës është ky Ramë. Padyshim përgjegjësi shtetëror është Thaçi, por përgjegjësi kombëtar është Rama. Projekti i sotëm i dorëzimit të verit të Kosovës, i kamufulluar nën përcaktimin 'shkëmbim terriore', nuk është as i ri dhe as i befalishëm. Përgatitja e tij nisi që kur në një aureolë ndërkombëtare, Rama kaloi portën e ndaluar të vizitës në Beograd në nëntor 2014. I bojatosur nga 'ustallarë' me një skenar perfid, përtej diplomacisë ai pati si episod PROVOKACIONIN e famshme, 'Kosova e paravarur, është tashmë një realitet', që po ta lexosh sot të detyron një nënqeshje të fortë ironike. E ç'nuk kemi dëgjuar në atë kohë për këtë 'trimëri'. Gjithçka u ndërtua për të zhvlerësuar, sado pak faktin e një realiteti të sanksionuar, autorë të cilit ishin dyshja Bush-Berisha dhe për të ndërftuar aty realitetin e sotëm Rama-Vuçiq, të copëtimit të Kosovës. Skenari funksionoi dhe të fituar dolën të dy. Rolet ishin ndarë e përcaktuar. Serbia ju gëzua dhe një përfitimi ekonomik ekzemplar me rrugën Nish-Beograd, pak më vonë. Ndërsa Rama u përcoll me një të kënduar 'O Sole mio' i Ballkanit, si përgesheje e sinqertë dhe e gëzuar serbe nga Daçiq. Dhe vërtet dielli ja kishte ndihur dhe për serbët, përderisa faktori i stabilitetit në rajon, "karikatura" e shqiptarëve e veshur shik, kishte pranuar me qejf "UKLAN-JENJA BRE?A-n". Që shqip-shqip quhet as më shumë e as më pak TRADHTI KOMBËTARE, të për mbajtur në dorë brekët e pushtetit. E kjo 'heqje brekësh' sot është duke u shpërfaqur në gjithë dimensionin e saj të nguljes së thikës pas shpinës së kombit".

Kreu i grupit parlamentar, në Bari për projektet ekonomike

Balla: Të gjejmë mundësi të tjera bashkëpunimi me Italinë

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, mori pjesë në një takim të organizuar nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit "Aldo Moro" të Barit, ku u diskutuan një sërë çështjesh të rëndësishme të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Italisë, si dhe ecuria e deritanishme e Programit të financuar nga BE-ja "Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi". Gjatë fjalës së tij, Balla ka theksuar nevojën e forcimit e mëtejshëm ekonomik mes dy vendeve, e veçanërisht me rajonin e Pulias. Ndërkohë, gjatë një interviste dhënë në edicionin gjendror të lajmeve të "TeleBari", kryetari i grupit kuvendor socialist ka vlerësuar maksimalisht mbështetjen e qeverisë italiane në rrugën e Shqipërisë drejt integritimit të BE. "Dua të theksoj se



në planin institucional, qeveria e re italiane ka mbajtur po atë qëndrim të mbështetjes së vendeve të Ballkanit, por veçanërisht Shqipërisë, në rrugën e saj drejt Integritimit Europian. Edhe në mbledhjen e fundit të Këshillit Europian, ministri i Jashtëm, por e gjithë qeveria ka luajtur një rol mbështetës. Unë jam i bin-

dur se roli mbrojtës që Italia gjithnjë i ka bërë Shqipërisë do të mbetet i njëjti, por mbetem i mendimit se mund të gjejmë mundësi të tjera bashkëpunimi, të pashfrytëzuara akoma deri tani. Një bashkëpunim që nuk është vetëm përmes strukturave të mëdha evropiane si Projektet IPA, por duhet të gjejmë edhe mundësi të tjera. Unë u kthehem gjithmonë mundësive që ofron Shqipëria për bizneset italiane të vogla dhe të mesme. Ka mundësi shumë të mira për të zhvilluar këto biznese në Shqipëri duke bërë të njëjtat investime, por në një vend më afër, i cili është vetëm pak orë distancë me target", - u shpreh Balla. Më tej, ai është ndalur në nevojën e rritjes së bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve, duke u përshtatur me tendencat e zhvillimeve rajonale dhe globale.

SHPLLJJE ANKANDI
Datë 17.08.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Agron Shefqet Burhani dhe dorëzueses Hatibe Shefqet Burhani:
"Apartament barri - Tisaf" me sipërfaqe 62 m2, nr. pasurisë 14/301, zona kadestrale 3574 e regjistruar në regjistrin hipotekor numër 2561 datë 07.10.1994, adresa: Lajçja "15 Shtatori", pallati 53, shikalla 1, apartamenti 4, Topelentë.
Çmimi fillestar i ankandit të parë është në shumën 1.280.000 (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
Ankand do të zhvillohet, ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

PERVJETORI AKUZAT

Berisha: Rama të dënojë krimin e të atit dhe t'i kërkojë ndjesë publike familjes

Basha, kujton Havzi Nelën: Të ngremë krye kundër tiranisë

"E keqja përsëritet, nëse s'dëgjojmë kumtin e poetit"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha ftoi dje shqiptarët që ngrihen kundër tiranisë tekta përkujtoi Havzi Nelën, poetin e vrasë nga diktatura komuniste. Për Bashën, Havzi Nela është personi që e sfidoi me forcë diktaturën dhe vazhdon të rëndojë "mbi ndërgjegjen e atyre që ende nuk i kanë dënuar krimet e komunizmit dhe xhelatët e tij dhe të mijëra shqiptarëve të pafajshëm". Kreu i PD-së shprehet: "E keqja përsëritet, nëse nuk e dëgjojmë kumtin e Havzi Nelës se çfarë të zezash e presin atë popull dhe shoqëri ku vdes fjala e lirë dhe shpirti i kundërshtimit ndaj së keqes". Sipas tij, "nderimi më i madh për poetin kryelartë të lirisë është të ngremë krye kurdoherë kundër tiranisë së të keqes, për liri, për demokraci, për Zot dhe atdhe, për veten dhe fëmijët tanë!". Poetit Havzi Nela u var më 10 gusht 1988 nga regjimi diktatorial i Hoxhës për poezitë e tij. "Pas 21 vitesh burg, tortura dhe internime, diktatura humbi çdo shpresë që ta mposhte shpirtin e tij të lirë, ndaj vendosi ta vrasë në mes të

Kukësit për ta bërë shembull. Por vetëm e përjetësoi Havzi Nelën, martirin e lirisë. Mbi një komb të tërë rëndon edhe sot mëkati për varjen në litar të një poeti për vargjet e tij! E zezë është faqja e atij kombi që pranon të predikojnë sot për drejtësi xhelatët e pandëshkuar të krimeve të komunizmit dhe bijtë e tyre të papenduar! E keqja përsëritet nëse nuk e dëgjojmë kumtin e Havzi Nelës se çfarë të zezash e presin atë popull dhe shoqëri ku vdes fjala e lirë dhe shpirti i kundërshtimit ndaj së keqes. Nderimi më i madh për poetin kryelartë të lirisë është të ngremë krye kurdoherë kundër tiranisë së të keqes, për liri, për demokraci, për Zot dhe atdhe, për veten dhe fëmijët tanë!", tha Basha.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

THIRRJA

Edhe ish-Kryeministri Berisha publikoi një mesazh

në rastin e 30-vjetorit të varjes nga regjimi komunist të poetit disident Havzi

Nela. Berisha shkruan se "se ky krim u ekzekutua me firmat e Ramiz Alisë dhe Kristaq Ramës, babait biologjik të kryeministrit aktual Edi Rama dhe se i bën apel kryeministrit të kërkojë falje". "30 vjet më parë me firmën e xhelatëve të diktaturës hoxhiste Ramiz Alia dhe Kristaq Rama, babai biologjik i Edi Ramës, u ekzekutua me varje në sheshin kryesor të qytetit të Kukësit, për t'u bërë përjetë i pavdekshëm, poeti disident Havzi Nela. Varja publike e poetit disident me urdhër të xhelatëve Ramiz Alia dhe Kristaq Rama, vetëm se guxoi në poezitë e tij të përmendë fjalën të drejtë e njeriut apo në një tjetër të shkruaj për 'frymën e Helsinkit', vetëm një vit para rënies së Murit

të Berlinit tronditi mbarë opinionin publik shqiptar dhe botëror: Edvin, sot është 30-vjetori i varjes në litar në sheshin qendror të qytetit të Kukësit, me firmë të xhelatëve Ramiz Alia dhe Kristaq Rama, babait tënd biologjik, i poetit disident Havzi Nela", shprehet z.Berisha. Ai i drejtoi një mesazh kryeministrit të vendit: "Sot është një ditë që Edi Kristaq Xhelati mund të 'varë' brenda vetes çnjerëzoren e neoblokmenit dhe të tregojë qoftë edhe për pak çaste një grimcë ndërgjegje të njeriut të qytetëruar, të dënojë krimin mizor të të atit të tij xhelat dhe t'i kërkojë ndjesë publike familjes dhe së paku botës së letrave për varjen me firmën e Ramiz Alisë dhe Kristaq Ramës të poetit disident Havzi Nela".

Tritoli në "Jon", pronarët marrin 13 milionë euro Strasburg, vjehri i Bashës, Xhafer Isufi fiton betejën me qeverinë



Padia e Isufit dhe 18 personave të tjerë që kishin blerë banesë në këtë pallat është pranuar nga gjykata. Gjykata e Strasburgut në vendimi i publikuar paraditen e kësaj të enjteje i dëmshpërbleu 19 paditësit me 13 milionë euro në total. Gjyqtarët e Strasburgut kanë arritur në përfundimin se shteti shqiptar është përgjegjës për shkeljen e disa neneve të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut.

LISTA ME EMRAT QË DËMSHPËRBLEHEN

- 1 Ballanca Erinda 191,406.28 euro
- 2 Basha Arben 191,406.28 euro
- 3 Calliku Gerti 163,492.86 euro
- 4 Calliku Valbona 95,703.14 euro
- 5 Deromemaj Abdul 129,598.00 euro
- 6 Durrolli Eduard 182,909.27 euro
- 7 Hanxhari Ilonka dhe Mihallaq 1 14,187.86 euro
- 8 Kacorri Vullnet 129,598.00 euro
- 9 Kapidani Klima 200,965.41 euro
- 10 Mecaj Mimoza 147,486.44 euro
- 11 Pojani Teri 89,349.02 euro
- 12 Rakipaj Pano 89,349.02 euro
- 13 Rakipaj Baki 92,572.66 euro
- 14 Schenetti Giuliano 98,237.33 euro
- 15 Sopotit Etnik 113,647.48 euro
- 16 Dorina Ylli 200,070.99 euro
- 17 Xhafer Isufi (35 prona) 6,220,296.42 euro
- 18 Xhuvit Sharxhi (3 pronarë) 867,556.60 euro
- 19 Xhafer Isufi dhe Xhuvit Sharxhi 7,246,424.23 euro



"Rama bën korrupsion me pronën publike"

PD: Qeveria "Rama" i shkaktoi shtetit 19 milionë euro dëme

Opozita kritikoi dje qeverinë "Rama", pasi sipas saj, i shkaktoi shtetit dhe shqiptarëve një dëm prej prej 19 milionë eurosh me pronën publike. Deputetja e PD, Dhurata Çupi, deklaroi se prona publike është tjetërsuar sipas interesave korruptive të maxhorancës. "Një nga rekordet e kësaj qeverie është korrupsioni me pronën publike. Me një dëm prej 19 milionë eurosh, qeveria e Edi Ramës është sjellë si pushtuese me pronën publike, duke e dhënë atë apo tjetërsuar sipas interesave të saj mafioze, korruptive dhe klienteliste. Kur erdhni në pushtet 5 vjet më parë, kjo qeveri gjeti inventarin e çdo prona publike të Republikës së Shqipërisë, në nivel qendror dhe lokal. Por, në vend që ky inventar të shërbente për të mirën publike për të gënjëruar të ardhura apo për t'u përdorur si fond kompensimi për pronarët, prona publike janë përdorur për të pasuruar miqtë dhe klientët e Edi Ramës. Dikujt i është dhënë me koncesion, dikujt tjetër me qira 90 vite", deklaroi zj.Çupi. Ai bëri të qartë se: "PD është e angazhuar për të kryer një hetim dhe analizë të plotë të çdo prona publike të vjedhur e grabitur këto 5 vite. Askush nuk do të gëzojë një pronë publike të marrë me korrupsion, në kundërshtim me ligjin".

Këngëtarët Era Rusi, Land Kademi, Renis Gjoka "tërbojnë" pjesëmarrësit në event, japin spektakël

KORÇË

Nata e tretë e Festës së Birrës ka "ndezur" qytetin juglindor. Tingujt e muzikës, shoqëruar me shijen e pakrahueshme të mbretëreshës shqiptare, "Birra Korça" kanë "tërë" vendësit dhe turistët. Në natën e tretë kanë mbushur sheshin mijëra vetë. Ritmi i festës tashmë ndihet në çdo cep të këtij qyteti. Ndryshe nga netët e tjera, risia e natës që kaloi ka qenë prania e shumë vizitorëve nga qytete të ndryshme të Shqipërisë. Vizitorë të shumtë, kryesisht nga Tirana, Durrësi, Elbasani, Fieri dhe Vlora kanë zgjedhur të kalojnë disa orë festive nën shoqërimin e "Birrës Korça" dhe këngëve të interpretuara nga këngëtarët e njohur shqiptarë si: Era Rusi, Land Kademi, Renis Gjoka etj. Këngëtarët kanë sjellë një 'show' të vërtetë dhe kanë bërë që të gjithë pjesëmarrësit të ngrenë lart gotat e mbushura me "Birra Korça" dhe të këndojnë së bashku. Fundjava e ka rritur edhe më tepër numrin e pjesëmarrësve, aq sa organizatorët e kanë pasur të vështirë të bëjnë një përlogaritje dhe të japin një shifër të atyre që morën pjesë mbrëmje në këtë festë. Në edicionin e 12-të të Festës së Birrës, gjithçka duket edhe më e bukur, duke i veshur Korçës për 5 net me radhë petkun e gëzimit, muzikës dhe kërcimeve nën shoqërimin e birrës. Në natën e tretë të festës, tavolinat dhe stolat janë kthyer në minipista kërcimi, ku të gjithë i janë bashkuar atmosferës deri në orët e para të mëngjesit të sotëm. Tashmë kjo festë është kthyer në një eveniment gjigant, që mund të krahasohet vetëm me festivalat më të suksesshme botërore. Festa është hapur me qytetarët që mbanin në duar dhe

Mijëra veta e gdhijnë në shesh me "Birra Korça"

"Ndizet" qyteti i serenatave, 'mësyjnë' turistët nga e gjithë Europa



bënin gëzuar me gotat e "Birra Korça". Mijëra pjesëmarrës kanë shijuar një mbrëmje të zjarrtë, ku skeja dhe sheshi i përngjanin një cikloni shpërthyes falë ritmit të sjellë nga këngëtarët, të cilët kanë performuar gjatë gjithë mbrëmjes dhe "Birra Korça" është konsumuar pa limit. Muzika është ndërthurur harmonishëm me natyrën e festës, ku së bashku me temperaturat e larta,

pjesëmarrësit nuk kanë ndalur së kërkuari e konsumuari "Birra Korça", e cila ruan me fanatizëm cilësinë e saj, duke sjellë një produkt të sigurt e të garantuar për konsumatorët. Para stendave të "Birra Korça", pjesëmarrësit kanë qëndruar në pritje, ku më së shumti shiheshin duke kryer një gjest miqësor; për t'i ofruar njëritjetrit një gotë birrë dhe për t'i dhënë festës tonalitetin e një mbrëmjeje, ku

shpreh se ka ardhur enkas për këtë festë, pasi kishte dëgjuar nga miqtë e tij. "Është vërtet interesante Festa e Birrës këtu në Korçë, ka dinamikë. Të bën të kërcesh, edhe pse duhet t'i rezistosh tundimit. Unë kam ardhur enkas nga Gjermania për të, pasi disa miq më thanë se do të niseshin për të marrë pjesë në këtë festë dhe unë nuk u mendova gjatë. U befasova nga ajo që ndodh këtu. Pashë që të gjithë njerëzit shkonin tek stendat e 'Birra Korçës' dhe unë shkova ta provoj. Ka shije të mrekullueshme. Unë jam njohës i birrës, pasi më pëlqen ta konsumoj dhe kjo që po i është një birrë me shumë cilësi. Ndër më të mirat që kam provuar do thosha", u shpreh turist i gjerman. Ndërsa, disa turistë nga Italia, Franca dhe Holanda pohuan se çdo gjë është jashtë pritshmërive të tyre. "Atmosfera, muzika dhe sidomos shija dhe cilësia e 'Birra Korçës' na kanë mrekulluar. Kjo birrë do të ketë më shumë mundësi për të konkurruar tregjet e BE-së", thanë turistët italianë dhe holandezë.

argëtimi është pa limit. Deri në orët e para të mëngjesit, mijëra gota birre të konsumuara kanë qenë panorama dominuese e festës, e cila pavarësisht gjithçkaje, mbetet një festë që dëshmon qytetari dhe kulturë.

TURISTËT

Jurgen, turist nga Gjermania u



Implemented by giz

ANNOUNCEMENT

Private Vocational Training Providers – Call for (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals

The GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED), implemented on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development, under the component of Technical Vocational Education & Training (VET), will cooperate with private vocational training providers in the country with the aim to scale-up VET interventions, complementary to the courses offered by public VET providers.

In this respect, the programme is conducting a Call for (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals from **23 July – 20 August 2018**, which shall help to identify private training providers that offer Vocational Training (VT) in line with the requirements below:

- Under each contract, the private training providers, will offer several training courses. The training duration of each course per batch should be at least 1 month.
- The training courses under each contract should target altogether 50-150 young people (19-34 years) in total. 40% of the participants are to be female and 30% are to be returning migrants from EU Member States.
- The courses should reflect the following prioritized sectors: ICT, tourism, agro-processing, textile & footwear and innovative/creative crafts, but are not necessarily limited to these sectors, if justified based on local labour market needs and employment prospects.
- The courses should be demand-driven and include work-based learning based on local labour market needs and eventually aim at employment.
- The proposals should reflect and include information on job placement mechanisms to guarantee employment of minimum 50% of the participants.
- There is no limitation in terms of geographical location, though priority will be given to (rural) locations where public/private vocational training is non-existent or very limited.
- The overall implementation timeframe for the interventions is up to 9 months.

The proposals that are to be selected through this call shall receive financial support ranging between 30,000 – 50,000 EURO (equivalent in ALL). The number of contracts is flexible until the overall programme budget of EUR 400,000 assigned for this activity is allocated.

Selection Procedure:

First step: All (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals received by applicants will be evaluated based on the eligibility and technical criteria described in the evaluation grid.

Second Step: The potentially qualified candidates will be invited for interviews and required to submit a budget proposal.

Third Step: Contracts will be awarded to the companies with best technical and financial offer.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to receive the Proposals format and the Evaluation Grid.

For further questions contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period 23 July – 20 August 2018.



Implemented by giz



Press Notice

To the attention of the general public Make it in Albania – OPENING OF THE SECOND CALL FOR PROPOSALS

Following its mandate from the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) and in partnership with the Ministry of Economy and Finance (MoEF), the GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED) under its third component of Social Participation of Marginalized Youth and Minorities is **opening its Second Call for Proposals from 23 July – 21 August 2018**.

The aim of this call for proposals is to financially support local civil society organizations, to implement small-scale projects that strengthen social empowerment and cohesion, and enable the target group to engage actively, in line with their interests and capabilities, to find common solutions to improve their-, and their respective communities' social and economic situations.

All CSOs registered in Albania with at least 2 years of relevant experience and proven record in youth empowerment and social cohesion are invited to submit proposals under this call for proposals.

The 10 envisaged proposals to be selected through this competitive call shall receive financial support in the amount between 10,000 – 20,000 EUROs (equivalent in ALL).

The proposed interventions submitted by the local CSOs may take different shapes and may include activities that strengthen the interaction between different groups of youth, activities that contribute to the development of life skills, cultural and sports activities, as well as activities that foster the inclusion of minorities, women, persons with disabilities and migration returnees. The long-term outcome of these activities should aim at increasing the target group's social capital and future employability prospects.

In order to submit a proposal for participation in this call, it is necessary to consult the Application Guidelines that may be obtained by it through the ProSEED Facebook page. The Application Guidelines state the defined objectives, and requirements to be complied with and provide detailed information on the procedures for selection. Interested local CSOs can find all the official templates for submitting proposals under this call annexed to these guidelines. Applying CSOs shall submit their applications only electronically to makaitinalbania@giz.de. All applications must be submitted in English language.

For further questions and clarifications on the Application Guidelines, please contact us via email to: makaitinalbania@giz.de during the period **16 – 20 of July 2018**, prior to the opening of the call. After this period GIZ ProSEED shall not answer any enquiry related to the call.

The deadline for the submission of the proposals is 21 August 2018, 16:00h.

VETINGU ANKIMIMET

U konfirmuan në detyrë, kush janë pesë subjektet për të cilët u rekomandua ankimim

Vetingu, ONM kërkon shkarkimin e gjyqtarit Malaj

KPK rrëzoi raportin e DSIK për lidhjet e magistratit me elemente kriminale

Operacioni Ndërko mbëtar i Monitorim it i paraqiti Komisionerëve Publikë ditën e djeshme rekomandimin për të ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit vendimin e KPK-së për konfirmimin në detyrë të të Artur Malaj. Magistrat në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, njëkohësisht kandidat për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, u konfirmua në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me 3 gusht. Pavarësisht se Malaj kaloi me sukses të tria shtyllat e rivlerësimit, ndërkombëtarët dolën kundër gjykatësit. "Trupi gjyqësor pasi dëgjoi zotin Malaj, e konsideron të përfunduar seancën dëgjimore. Në përfundim të këtij procesi të rivlerësimit trup gjyqësor, vendosi konfirmimin në detyrë të zotit Artur Malaj", deklaroi më herët relatorja Genta Tafa Bungo. Ndërkohë në seancën dëgjimore, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit doli kundër DSIK për Malaj. DSIK e konsideronte të papërshtatshëm Malaj për të vijuar ushtrimin e detyrës pasi ishin zbuluar lidhje të tij me elemente kriminale. Në raportin e këtij institucioni thuhej, gjithashtu, se ka dyshime se Malaj është përfshirë në afëra korruptive gjatë kohës që ushtronte detyrën e kryetarit të gjykatës në Vlorë. Ai dyshohet se ka favorizuar palët në proces kundrejt rryshfetit. Komisioni tha se pasi administroi dosjet gjyqësore dhe i shqyrtoi ato arriti në përfundimin se raporti i DSIK ishte i paplotë dhe i pabazuar. Gjatë hetimit administrativ ai ka rezultuar me probleme edhe sa i përket shtyllës së pasurisë, pasi kishte dyshime që ka bërë kontratë notoriale fiktive me një ndërtues për blerjen e një apartamenti me Tiranë, ndërsa personat e



Gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, Artur Malaj

ARTUR MALAJ

KPK doli kundër DSIK për gjykatësin e Apelit Administrativ, Artur Malaj. DSIK e konsideronte të papërshtatshëm Malaj për të vijuar ushtrimin e detyrës pasi ishin zbuluar lidhje të tij me elemente kriminale. Në raportin e këtij institucioni thuhej, gjithashtu, se ka dyshime se Malaj është përfshirë në afëra korruptive gjatë kohës që ushtronte detyrën e kryetarit të gjykatës në Vlorë. Komisioni tha se pasi administroi dosjet gjyqësore dhe i shqyrtoi ato arriti në përfundimin se raporti i DSIK ishte i paplotë dhe i pabazuar.

51

ÇËSHTJE

Bazuar në vendimet e marra në 51 çështje të shqyrtuara nga marsi deri në fillim të gushtit, ISP pas monitorimit të procesit i ka renditur gjykatësit mbi bazë të numrit të çështjeve që kanë shqyrtuar dhe qëndrimin që kanë mbajtur. Sipas të dhënave të publikuara nga 12 anëtarë, 5 anëtarë të KPK-së kanë dhënë më shumë vendime shkakimi se sa konfirmimi.

bashkëlidhur me të nuk kishin të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar

një vile në Vlorë ku gjykatësi zotëron një pjesë të kësaj prone. Konkretisht gjyqtari kishte dy troje të përfutur me ligjin 7501 në Llakatund të Vlorës, një apartament në kryeqytet, garazh dhe një automjet. Ndonëse konstatoi disa parregullsi në shumta të papërfillshme, KPK vlerësoi si të deklaruar saktë ndër vitet dhe të justifikuar edhe tri llogari të bashkëshortes së tij, gati 200 mijë euro në total, të përfutura nga puna e saj si notere. Gjatë kësaj seance dëgjimore për rreth 20 minuta, gjyqtari bëri pyetje e përgjigje me vëzhguesin ndërkombëtar. Kujtojmë se pas konfirmimit në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, gjyqtari i Gjykatës Administrative të Apelit të Tiranës, Artur Malaj ka folur me gazetaret pas vendimit. Malaj është shprehur se falënderon KPK-në për rikonfirmimin dhe se

tani mund të vazhdojë i qetë garën për kreun e ILD-së. "S'kam asnjë koment. Falënderoj KPK-në për punën e bërë. Do të vazhdoj detyrën ashtu si edhe më parë. Unë jam një nga kandidatët e ILD-së, për këtë arsye iu nënshtrova vetingut të përshtypur, gara për kreun e Inspektoratit të Lartë i Drejtësisë do të vazhdojë, nuk e di se si do të mbarojë. Por di të them që ambicia ime është ILD-ja", u shpreh më herët Malaj. Por një javë pas vendimit, ONM kërkon të rishikohet vendimi i KPK. Komisionerët Publikë, pasi t'u jetë njoftuar vendimi me shkrim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, do ta shqyrtojnë atë krahas rekomandimit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. **ANKIMIMET** Ky është rekomandimi i pestë nga ONM për të ankimuar vendimin për 5 subjekte të rivlerësimit që

SUBJEKTET PËR TË CILËT ONM KA REKOMANDUAR ANKIMIMIN

- ◆ Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese Bashkim Dedja
- ◆ Kreu i Gjykatës së Lartë Xhezair Zaganjori
- ◆ Gjyqtari i Administratives Gentjan Medja
- ◆ Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Gentian Osmani
- ◆ Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Artur Malaj

39%

E MESHKUJVE

Sipas ISP vetëm 39 për qind e meshkujve gjykatës dhe prokurorë të përfshirë në proces rivlerësimi janë konfirmuar. Përkundër kësaj 69 për qind e femrave gjykatëse dhe prokurorë kanë kaluar me sukses procesin e vetingut.

ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka 30 ditë afat për t'ia njoftuar vendimin me shkrim Komisionerëve Publikë. Ky vendim ende nuk është njoftuar. Bazuar në pikën 1, të nenit 63, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisionerët Publikë, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Komisionerët Publikë përfaqësojnë interesin publik gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Shitje me Ankand të Pare nga Studio Perbarimore L.D.C

"Ndertese", me siperfaqe 600 m2, me Nr. Pasurie 495/15, Vol 5, fq. 83, ndodhur ne ZK 3426 me adrese ne Tufine, Tiranë. Regjistruar ne Z.V.R.P.P Tiranë ne emer te Zyber KUKA. Çmimi fillestar per shitje eshte 3.360.000 Leka.

Data e shpalljes 01.08.2018
Data e zhvillimit 24.08.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Perbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
Zyra përmbartimore "Best 2018"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 06 shtator 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyre përmbartimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandit i I-rë, për shitjen e a) nr.pasurie 26/106-1-26, vol 52, fq 1, ZK 8603, me crmim fillestar 4725000 lek; b) nr.pasurie 26/187-ND, vol 52, fq.28, me çmim fillestar 35938000 lek.

Të dyja prona ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petrol Marku", Vlorë) që ka ndërtuar Dëbtori "CO.BE.IN" s'hpk (NUIS J97201218L)

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

Perbaruesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :

Tuall-Ndertesë e regjistruar ne regjistrimin hipotekore me nr pasurie 9268 ne ZK nr 8502, me nr prone 47, me siperfaqe totale 161 m², nga kjo 66 m² ndertesë me adrese i partizani ne Shkoder

2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja ne Ankand per pasurine e siperpershkruar, eshte ne vleren 2,016,000 (Dymilione e gjashtembdhjetemije) Leka.

Shitja e pasurise do te behet (zhvillohet) me date 15.08.2018 ora 16:16 ne Zyren e perbaruesit gjyqësor Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhin parapara fillimi te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogaria 41064051.

Bashkia: Projekti "Fun Run", edukim i brezave të rinj

Rikthehet Maratona e Tiranës, më shumë se 2500 vrapues nga 40 vende të botës

Maratona e Tiranës 2018 do të vijë këtë vit me edicionin e saj të 3-të, si event i më i madh sportiv në vend. Në këtë aktivitet do të marrin pjesë më shumë se 2500 vrapues nga 40 vende të ndryshme të botës. Rritja e numrit të pjesëmarrësve ndër vite është një tregues i mirë, se kjo garë është bërë e dashur për qytetarët e Tiranës dhe më gjerë. Edicioni i 3-të i këtij aktiviteti, i cili tashmë po kthehet në traditë organizohet me aprovimin e dy itinerareve të rinj nga Federata Botërore e Atletikës duke i dhënë seri-

PROJEKTI

Me projektin "Fun Run" Bashkia e Tiranës synon të edukojmë brezat përmes sportit, për të qenë të vendosur dhe me vetëbesim, në rrugën e tyre për të arritur qëllimet e tyre. Gjithashtu, kjo të jetë një mënyrë e mirë për t'i nxitur të angazhohen me sport dhe të fillojnë të përgatiten për të konkurruar pas disa vitesh në Maratonën e Tiranës.



ozitetin e një aktiviteti ndërkombëtar dhe me mbështetjen e Federatës Shqiptare të Atletikës.

Gara do të mbahet me datë 7 tetor dhe do të ketë 3 kategori; Half Marathon (21, 0975 km), Tirana 10K dhe "We too" kjo një kategori që ka për qëllim të jetë

më shumë motivuese se sa kompetitive. Nuk do të mungojë as gara "Fun Run", e cila do të zhvillohet një ditë para garës së madhe me datë 6 tetor 2018 me të rinjtë e shkollave të mesme të Tiranës. Me projektin "Fun Run" Bashkia e Tiranës synon të edukojmë

brezat përmes sportit, për të qenë të vendosur dhe me vetëbesim, në rrugën e tyre për të arritur qëllimet e tyre. Gjithashtu, kjo të jetë një mënyrë e mirë për t'i nxitur të angazhohen me sport dhe të fillojnë të përgatiten për të konkurruar pas disa vitesh në Ma-

ratonën e Tiranës. Itineraret e rinj të certifikuar nga Federata Ndërkombëtare e Atletikës - IAAF, do të përshkruajnë pikat më atraktive të qytetit duke e kthyer këtë garë jo vetëm në sfidë, por edhe në argëtim. Përveç se një ngjarje sportive për garuesit,

do të mund të konsiderohet edhe një ditë festive për qytetin, në të cilin do të organizohen shumë aktivitete artistiko-kulturore në kuadër të këtij event. Çmimet për fituesit do të jenë të shumta, duke e kthyer garën në një sfidë.

Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme: Zgjerim i gamës së shërbimeve 'online'

Voltiza Duro

Certifikata për emigrantët shqiptarë në 12 shtete

"Reduktim i kohës dhe lehtësim për shtetasit jashtë kufijve"

Tashmë në 12 shtete të ndryshme të botës, do të ofrohen shërbime të tjera për të gjithë emigrantët shqiptarë që janë rezidentë në këto vende. Lajmi është bërë më dije ditën e djeshme nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme e ka të bëjë me mundësinë që kanë tani shqiptarët që ndodhen përtej kufijve për të marrë një certifikatë personale apo familjare në vendet ku jetojnë. Respektivisht shqiptarët mund të marrin këto shërbime të reja në këto 12 vende: Vjenë,

Sofje, Pragë, Budapest, Prishtinë, Zagreb, Tokio, Podgoricë, Bukuresht, Bratislavë, Bernë, Ambasada Ankara dhe Konsullata në Stamboll. "Në vijim të zbatimit me sukses të lëshimit të Certifikatave të Lindjes ose Familjare për shtetasit shqiptarë në Itali, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme njofton se ky shërbim është zgjeruar edhe në 12 shtete të tjera të botës. Tashmë shtetasit shqiptarë me rezidencë në këto vende mund të tërheqin Certifikatën e Lindjes ose Familjare nëpërmjet Përfaqësive të RSH-së", theksohet në njoftimin e ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme.

SHËRBIMET QË OFROHEN

Sipas Ministrisë për Eu-



ropën dhe Punët e Jashtme, shtimi i numrit të shërbimeve dhe lehtësirave të shqiptarëve jashtë kufijve në plot 12 shtete të tjera përbush më tej objektivat dhe prioritetet e qeverisë shqiptare. "Ofrimi i këtij shër-

bimi nga ministria përbush objektivat dhe prioritetet e qeverisë shqiptare për: ofrimin e shërbimeve ndaj shtetasve shqiptarë jashtë territorit të RSH-së; lehtësimin dhe reduktimin e ndjeshëm të kohës për

marjen e këtyre shërbimeve nëpërmjet Përfaqësive Diplomatieke dhe Konsullore; si dhe zgjerimin e gamës së këtyre shërbimeve online", nënvizohet më tej në njoftimin e ministrit.

12

SHTETE

Në 12 shtete të ndryshme të botës, do të ofrohen shërbime të tjera për të gjithë emigrantët shqiptarë që janë rezidentë në këto vende. Lajmi ka të bëjë me mundësinë që kanë tani shqiptarët që ndodhen përtej kufijve për të marrë një certifikatë personale apo familjare në vendet ku jetojnë.

SHTETET

- ◆ Austri- Vjenë
- ◆ Bullgari- Sofje
- ◆ Çeki- Pragë
- ◆ Hungari- Budapest
- ◆ Kosovë- Prishtinë
- ◆ Kroaci- Zagreb
- ◆ Japoni- Tokio
- ◆ Mal i Zi- Podgoricë
- ◆ Rumani- Bukuresht
- ◆ Sllovaki- Bratislavë
- ◆ Zvicër- Bernë
- ◆ Turqi- Ambasada
- ◆ Ankara+Konsullata Stamboll

Klosi: 17% më shumë pushues se një vit më parë

Shqipëria dhe Kosova me ofertë të përbashkët turistike



Tashmë mes Shqipërisë dhe Kosovës do të ketë një ofertë të përbashkët turistike. Dakordësimi për një bashkëpunim në fushën e turizmit është diskutuar midis ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi dhe ministrit të Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës, Bajram Hasani, gjatë takimit të mbajtur dje në Prizren. Ministri Klosi tha se palët do të punojnë në ndërtimin e një strategjie në mes dy vendeve në fushën e turizmit për të realizuar një

ofertë të përbashkët përfshirë edhe vendet e Ballkanit. Në këtë kuadër ministri Bajrami tha se pritet që në fillim të vjeshtës në Brezovicë, apo Rugovë të bëhet hapja e sezonit turistik, për tërheqjen e sa më të madhe të turistëve

nga vendi dhe rajoni. Në takimin e tyre ministrat ndanë edhe zhvillimet më të fundit të sezonit turistik në Shqipëri. Ministri Blendi Klosi u shpreh se është rritur me 17 përqind numri i turistëve këtë korrik krahasuar me vitin paraardhës, ku rritje ka patur edhe numri i pushuesve nga Kosova. Më tej Klosi theksoi se duhen politika të përbashkëta për të promovuar agro-turizmin, fshatrat turistike dhe trashëgiminë kulturore.

ISH-TE PERNDJEKURIT DOKUMENTET

Përfituesit e kështit të parë dhe të dytë, dokumentet në Drejtorinë e Pagesave

Ornela Manjani

Ish-të përndjekurit, 650 trashëgimtarët marrin paratë

Ministria e Financave: Dorëzoni numrin e llogarisë dhe certifikatat

Rreth 650 fëmijë ish-të dënuarish politikë, trashëgimtarë të radhës së parë do të marrin dëmshpërblimin. Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë jo parësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të dorëzojnë dokumentet deri brenda 3 muajve. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të kështit të dytë të dorëzojnë në drejtorinë e pagesave numrin e llogarisë për të marrë dëmshpërblimin. Lista me përfituesit, të cilët janë në radhë për kështin e tyre të parë dhe të dytë, duhet të përditësojnë numrin e llogarisë bankare, si dhe të dorëzojnë fotokopje të mjetit të identifikimit dhe

çdo dokument tjetër që u mundon në dosje. **DOKUMENTET**
Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe

ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, goftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha do-

kumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes

civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton ndërkohë, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse

dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", -thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve që nuk kanë marrë ende dëmshpërblimin.

650 TRASHËGIMTARËT MARRIN PARATË

NR. DOSJES	EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPJETE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE	CERTIFIKATE YDEKJE	CERTIFIKATE TRINGUT FAMILJAR	DESHMI TRASHËGIME
2149	TEREZE LUIGJ	LUCA(MIRI)			V	V	V	V	V
7403	TOMË NDUJE	KOCI			V	V	V	X	V
		GASPER LUIGJ	KOCI		X	X			
		VERA PELLUMB	KOCI		X	X			
8565	HAJRIE AËSHE AHMET	ALLA KULLAFI			V	V	V	V	V
	XHAMË NEXHMIJE MEREME	BARDHI LALA BALLA			V	V	V	V	V
11133	HANIFE ALLA	SINA			V	V	V	V	V
		HAJLIL HAJLIL	ALLA ALLA		V	V	V	X	X
8222	XHEJLIL	SADIKAJ					V	V	V
		HEKTOR MBETE	SADIKAJ BRILKA		V	V	V		
		KOCI BUKURIE	SADIKAJ VINIAU		V	V	V		
		BIJAR PERPARIM	SADIKAJ		V	V	V		
	ISMET	SADIKAJ					V		
		DEMO FERDINAND	SADIKAJ		X	X	X	X	
		AGIM KASTRIOT	SADIKAJ		X	X	X	X	
		ALBAN EDLIRA	SADIKAJ		X	X	X	X	
		ERMAL JONIDA	SADIKAJ		X	X	X	X	
	BEJKUSH	SADIKAJ			V	V			
8081	ALI	BRAHO	MUSA	BRAHO	V	V	V	V	V
	SHEMO NIKI	BRAHO EMINI			V	V	V	X	X
	LIPI SOFIE	BENDO			V	V	V		
	FATIME QERIM	AGOLLI BRAHO			V	V	V		
	MUHAMET	BRAHO			V	V	V	V	V
		ZHANETA DESDEMONA KASTRIOT	MARA HAJLIL BRAHO		V	V	V	V	V
		MIRELA	SANXHAKU		V	V	V	V	V
12953	LLUKAN	CICOLLI			V	V	V	V	V
		LETER THEMSTOKU	CICOLLI		V	V	V	V	V
		FORE	CICOLLI		V	V	V	V	V

NR. DOSJES	EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPJETE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE	CERTIFIKATE YDEKJE	CERTIFIKATE TRINGUT FAMILJAR	DESHMI TRASHËGIME
			JOSIF KLANTHI	CICOLLI	V				
			ALEXANDER	CICOLLI	V				
	ANDREA MIHAL	CICOLLI					X	X	X
			SPIRO KRISTAQ	CICOLLI	V	V	V	V	V
			GJERGJI SILVANA	CICOLLI	V				
			KLODIANA	CICOLLI	V				
	MARINA	PROKO			V			V	
			LILI	PROKO	V	V			
1475-A	DUHË ZENEL	KUQI(MERLIKA)					V	X	V
	BERAM TOMORR	MERLIKA			V	V	V	V	
	BIJAR	MERLIKA			V	V	V	V	
18341	ARIFE SALI	HOXHA			V	V	V	V	V
	MEFRAT	HOXHA			V	V	V	V	
	VANGJELISAT	THOMAN(HOXHA)			V	V	V	V	
	FATIME KADENE	DOLLANI ZENELI			V	V	V	V	
1217	RESMIJE RAHIM	LARAKU XHYRA					V	V	V
	BEHARE	MERSINA			X	X	V	V	X
20K38	REXHEP	SYLAJ					V	X	V
			SADRI	SYLAJ	V	V	V	V	V
2675	BAKI HYSEN	XHAFAJ XHAFAJ			V	V	V	V	V
			XHAFERR PASHAKO	XHAFAJ HYSINI	V	V	V	V	
			MYSERET FLAMUR	XHAFAJ LEZAJ	V	V	X	X	
			ZENGJINE	LEZAJ	V	V	V	V	
			LIRI FAIKE	SKENDERAJ SHEHAJ	X	X	X	X	
	SKENDER	XHAFAJ			V	V	V	V	V
			SABRI SOKOL	XHAFAJ GENTJAN	V	V	V	V	
			VALBONA HADERI	XHAFAJ HADERI	V	V	V	V	
			ALMIRA ALBANA	MANAJ KEQAJ	V	V	X	X	
			MAJLINDA	ALIAJ	V	V	V	V	
16405	MIRIKA RUTA	MARKU GJOKA			V	V	V	V	X
16723	LLULE ROMINA	MIRASHI			V	V	V	V	V



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 622

SUPLEMENTI I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Allaj - Art Designer: Nevila Samarxhi
E shtunë 11 Gusht 2018

KENGETARI

EROS RAMAZZOTTI



NE MIKONOS, 'FLIRTOV' ME ANGELA MARTININ NE SY TE BASHKESHORTIT



ENCA HAXHIA

'PROVOKON' KEQ, JA CILA ESHTË EMBELSIRA E PREFERUAR E SAJ

FLORIANA GARO: Ja projektet e mia për shtatorin

*Së shpejti do të kemi dasmë?
Rrëfëhet ish-moderatorja: Dasma do të zhvillohet në Shqipëri.
"Pjesa më e vështirë, të kuptuarit që je bërë nënë"*

RREFIMI
EKSKLUZIV




VIP-a NE PLAZH

Pushime apo lodhje për Emina Cunmulajn?

Modelë si vëllezërit

Ramosaj, edhe pak ditë edhe lind këngëtarja bukuroshe



Rikthehet Amarda Toska, më e ëmbël se kurrë

Pas një pauze jo shumë të gjatë pushimesh, Ami i është rikthyer punës me kokë në sallinin e saj të nuseve. Si gjithnjë e qeshur dhe plot sharm Ami duket si një vajzë e vogël në videon e postuar në 'Instastory'. E veshur me një fustan të kuq dhe me pak makeup bukuroshja duket në formë fantastike. Edhe pse nënë tashmë e dy fëmijëve, Ami duket se është në formën e saj më të mirë dhe plot energji. Për t'u marrë shembull apo jo?



'Provokon' keq Enca Haxhia, ja cila është ëmbëlsira e preferuar e saj

Të gjithë i pëlqejmë ëmbëlsirat, por kjo s'do të thotë që me patjetër duhet të postojmë mënyrën se si i hamë ato nëpër rrjetet sociale. Por mesa duket, mbretëresha e provokimeve nuk do t'ia dijë aspak dhe para pak kohësh publikoi në 'Instastory' se i kishin dhuruar një kupë me xhelatina dhe ajo nuk hezitoi të postonte edhe mënyrën se si konsumonte njërin prej tyre. Në foto do të duket më qartë provokimi i fshtëtë i këngëtares. A s'ju duket edhe ju kështu?

Pushime në Mikonos, Eros Ramazzoti 'flirtin' me Angela Martinin në sy të bashkëshortit

Ai është një nga këngëtarët italian shumë i njohur për publikun shqiptar dhe i preferuar, gjithashtu. Po flasim pikërisht për Eros Ramazzotin. Por nuk i referohemi një prej sukseseve të tij në muzikë, por si periudhë pushimesh, jemi fokusuar tek fakti se me kë është duke kaluar pushimet ai. Asnjërit nuk ia priste mendja, por Ramazzoti është pikërisht me modelen shqiptare Angela Martini. Së bashku me Angelën dhe bashkëshortin e saj, të shoqëruar dhe nga miq të tjerë, ata shfaqen në një jaht e më pas duke notuar në ujerat e kristalta të ishullit grek. Ka qenë Angela që i ka shpërndarë videot në 'Instastoryn' e saj dhe të gjithë duken të buzëqeshur dhe janë duke shijuar shoqërinë e njëri - tjetrit. "Pema e jetës", thotë Ramazzoti duke kapur dorën e modeles për t'iu referuar tatuazhit të saj. Një flirtim i vogël, i lejueshëm pse mos të bëhet kur je i shoqëruar nga një modele seksi si Angela.



Incident në plazh, Bes Kallakut i fryhet keq këmba

Është periudhë pushimesh dhe të gjithë pavarësisht kohës së relaksit që kalojmë kemi mundësi të hasim edhe incidente të vogla apo të mëdha në plazh, apo në vendet e nxehta. Kjo gjë i ka ndodhur edhe humoristit Bes Kallaku. Në një foto të postuar në 'Instastory', Besit duket se i është fryrë keq këmba nga pickimi i një grëreze. Gjëra që ndodhin me një temperaturë kaq të lartë dhe insektet e shumta që janë në qarkullim. Duhet bërë kujdes!


Elvana Gjata merr guximin e thotë pa 'ju dridhur qerpiku': Unë kam lindur për të...

Kanë kaluar shumë vite tashmë që nga koha kur Elvana Gjata u ngjiti në skenë për herë të parë. Sukses pas sukcesi, sot Elvana është një prej artisteve më të dashura për publikun. Eksperienca disavjeçare dhe dashuria e publikut duket se e kanë bërë këngëtares ta thotë me shumë vendosmëri se ka lindur për të kënduar dhe për të fituar. 'Kam lindur për të kënduar dhe për të fituar' – ka shkruar Elvana bashkangjitur fotos së saj në 'Instagram', shkëputur nga klipi i këngës 'Mike'. E pse jo, i takon ta pranojë një këngëtare e suksesshme si Elvana.



Arilena Ara guxon të postojë foton që s'e keni parë asnjëherë, ja si duket ajo

Arilena Ara është ndër të paktat këngëtare që prej daljes së parë në skenë duket që mund të quhet ujë e sapun. Ajo gjithmonë është shfaqur mjaft e thjeshtë dhe origjinale në daljet e saj si edhe në rrjetet sociale. Në fund të fundit më e bukur seç është nuk mund ta bëjë asnjë grimiere. Së fundmi ajo ka ndarë për fansat e saj një foto ku shfaqet e sapo zgjuar nga gjumi. Pak kush do të kishte guximin të ndante një foto të tillë. Dhe për habi të të gjithëve ajo sërish rrezaton bukuria e thjeshtësi.



Më në fund relaks dhe për Viola Spiron, prezanton njeriun më të dashur që e shoqëron

Më në fund pak relaks edhe për moderatoren bukuroshe, Viola Spiro. Ajo duket se nuk ka pritje për ditën e sotme, por e ka nisur që dje fundjavën e saj. Në ndalesën e parë që ka bërë në Llogora, Viola ka postuar foton me personin me të cilin do të kalojë këtë fundjavë. Meqenëse pas përfundimit të botërorit ajo u largua për në Greqi me miq, tani ka vendosur t'i dedikohet nënës së saj, Brunilda si dhe motrës së saj Petruela. Vajzat kanë zgjedhur jugun si destinacion dhe prezenca e njëra-tjetrës do ju zbukurojë këto ditë. E ku ka më bukur se familja!



Dhurata speciale për Dua Lipën, çokollata me imazhin e saj!

Artistja shqiptare Dua Lipa në Prishtinë pritet të ngjitet në skenë, për natën e parë të festivalit "Sunny Hill". Ndërkohë gjatë qëndrimit të vendin e origjinës së saj ajo ka shijuar edhe disa ditë të mira pushimi nën shoqërinë e të dashurit të saj, Isaac Caree. Me të mbërritur në Prishtinë, Dua ka marrë shumë surpriza nga mikpritja e ngrohtë, por njëra prej tyre është më e ëmbla. Një dhuratë speciale për Duan ka qenë ajo e organizatorëve të festivalit "Sunny Hill". Ata përmes një imazhi të publikuar në 'InstaStory' kanë shfaqur një pako të veçantë me çokollata, të cilat ishin të punuara enkas me imazhin e Duas. "Faleminderit për çokollatat e bukura", shkruhet në mbishkrimin e këtij imazhi. Duket se ardhja speciale e Duas ka bërë që shumë njerëz t'i futen punës për të krijuar diçka kreative për të, e me siguri me kënaqësinë të madhe.



THANK YOU for the beautiful chocolates! ❤️



VIP-a në plazh

Pushime apo lodhje për Emina Cunmulajn? Modelë si vëllezërit Ramosaj, edhe pak ditë edhe lind këngëtarja bukuroshe

Vijojmë si çdo fundjavë me maratonën tonë të listimit të vip-ave në plazh. Jemi ende në stinën më të nxehtë të vitit dhe padyshim që destinacioni i shumicës prej nesh është aty ku shijon më tepër relaksin dhe pushimet larg stresit të vapës dhe punës. Në lupën tonë këtë javë kanë qenë të gjithë ata që për fatin e tyre të mirë kanë marrë pushime për të tre muajt e verës. Kush në Shqipëri e kush jashtë vendit, ja destinacionet e preferuara të njerëzve më të lakuar të medias rozë:

Nga Pamela Aliaj

Fotot provokuese të femrave seksi buzë detit




Pushime apo punë për Emina Cunmulaj-n?

Ajo është një nga modelet më të dashura shqiptare, e cila njihet për ruajtjen e origjinës dhe gjuhës së saj edhe tek fëmijët dhe fansat që e ndjekin në rrjetet sociale. Ndërkohë që pas lindjes së vogëlushes së dytë, Mia Soraya, ajo së bashku me familjen e saj është duke shijuar një tur të gjerë pushimesh nëpër vendet më ekzotike të Amerikës. Ndërkohë që sa për të informuar fansat, Emina postoi para pak kohësh edhe itinerarin e ditës së saj të pushimeve, e cila duket se ishte vërtet një ditë si gjithë të tjerat pavarësisht se mund të jetë duke vizituar vende fantastike. E pra, me dy vajza të vogla, Emina ia del shumë mirë dhe pa dado t'i shijojë pushimet e verës!

Modelë si Alban dhe Beatrix Ramosaj

Ata janë motra dhe vëllai më të famshëm të vip-ave shqiptarë, të cilët Aqartazi e adhurojnë edhe modelingun. Beatrix dhe Alban Ramosaj janë duke shijuar prej tashmë më shumë se një muaji pushimet e paharrueshme në jug të Shqipërisë. Por mesa duket vëllezërit nuk janë vetëm, por janë të shoqëruar edhe nga fotografi i njohur, njëkohësisht edhe miku i tyre, Endrit Mërtiri. Diell, det dhe foto pafund janë rezultati i këtyre pushimeve të veçanta për Ramosajt. Kush me foto kartolinë e kush me foto provokuese, secili prej tyre duket se po kalon momente fantastike këtë verë! Presim të tjera foto sidomos nga Trixa!



Edhe 97%.. Adelina Tahiri poston foton më të ëmbël për këtë verë

Po karikohet...edhe 97%. Një foto shumë e bukur dhe kuptimplotë është hedhur së fundmi nga këngëtarja bukuroshe Adelina Tahiri. Mbase mund të jetë një nga fotot e fundit për këtë verë me bark të rrumbullakosur. Djali do shumë pak të vijë në jetë dhe duket se këngëtarja është duke e pritur me padurim. Një dorë që mban barkun dhe deti, një foto shumë e ëmbël e postuar nga Adelina për fansat këtë verë.



Alketa Vejsiut si ndahet shpirti nga jugu i Shqipërisë

Një tjetër personazh i dashur i ekranit duket se po shijon ende kripën e detit dhe rrezet e diellit në vendlindje. Alketa Vejsiu, edhe pse e rezervuar në fotot me bikini nuk i reziston dot bukurisë së natyrës blu dhe shpeshherë ndan me ne foto nga momentet e saj të relaksit. Jo vetëm një Etna-vullkan, siç e quajti veten para disa ditësh, por mund të themi se Alketa është një fansë e madhe e hapësirës blu, detit. Dhe vërtet ku më bukur se në bregdetin shqiptar mund të shijojë relaksin e kërkuar.



Sfilata, të qëshura dhe relaks! Këto janë pushimet e Roza Latit

Nga një bregdet në tjetrin, duket se pushimet e Rozës nuk kanë të sosur! Pasi shijoi disa ditë me familjen, Roza Lati i është rikthyer një turi tjetër pushimesh, ku kësaj radhe bashkudhëtare e saj është aktorja Anais Lika. Në një nga hotelet më të preferuara të moderatores, duket se vajzat janë duke kaluar momente shumë të veçanta plot humor e të paharrueshme. Sigurisht që pjesë të këtyre çasteve të dyja vajzat i kanë ndarë nëpër rrjetet sociale. Duke qenë se nuk ka kaluar ende as mesi i muajit do të presim të shohim ku do të jetë destinacioni i radhës i Rozës.

VIP-a në plazh

Pushime pa bashkëshortin? Ja ku shfaqet Orinda Huta

Punë programe dhe asgjë tjetër? Më në fund pak momente relaksi edhe për bukurshen bionde, Orinda Huta. Edhe pse e shohim shpesh të angazhuar në televizion dhe një hapësirë e vogël pushimesh u pa se bukurshja e bëri muajin e shkuar, mungojnë pushimet me Turin! Edhe pse vjet në këtë kohë çifti ishte duke shijuar plazhet ekzotike të muajit të tyre të mjalitit. Pas emërimit të Turit si drejtor ekzekutiv në Klan Plus, duket se pushimet do të vijnë pak me vonesë këtë vit për çiftin. Por meqë muaji nuk ka mbaruar ende, të shohim ku do të jetë destinacioni i tyre këtë verë.



Rozana Radi


Pas një sezoni të ngjeshur në "Boom" Rozi më në fund nisi pushimet e saj me familjen. Nga fotot e postuara në 'Instagram' duket se moderatorja dhe këngëtarja është në superformë këtë verë. Rozi zgjodhi të ishte jashtë Shqipërisë për të shijuar momente të paharrueshme me mbesën dhe familjen e saj. Pishina dhe natyrë janë vendet e preferuara të këngëtares këtë verë. E si të mos i pëlqejë, panorama pas saj duket fantastike!

Oceans view



Pak relaks dhe për Rita Orën

Më në fund dhe pak pushime për një nga këngëtares më të dashura shqiptare dhe mbarëbotërore, Rita Ora. Pas turit të saj të gjatë nëpër gjithë botën ajo ka mundur të gjejë pak hapësirë për veten e saj për të shijuar rrezet e diellit dhe freskinë e detit. Në fotot e videot e hedhura në 'Instagram' duket se ka pak frikë nga zhytja në det. Të jetë e vërtetë apo vetëm një 'show' i këngëtares.



Së shpejti do të kemi dasmë? Rrëfëhet ish-moderatorja: Dasma do të zhvillohet në Shqipëri

I rikthehet ekranit shqiptar?

Floriana Garo:

Ja projektet e mia për shtatorin

“Pjesa më e vështirë, të kuptuarit që je bërë nënë”



Edhe pse tashmë u bë më tepër se një vit që ajo është shkëputur nga mediat vizive shqiptare, të gjithë e mbajmë mend bukurshen e “Jo Vetëm Modë”. Tashmë larg Shqipërisë, Floriana Garo ka krijuar jetën e saj pranë bashkëshortit dhe vogëlushes disamuajshe, Adias. Por së fundmi e kemi parë që ish-misi shqiptar është rikthyer në vendlindje. Në një intervistë ekskluzive për “Bluetooth” të “Gazeta Shqiptare”, Floriana ka rrëfyer për planet e saj për këtë shtator edhe më gjerë. Ajo ka folur, gjithashtu, edhe për ndjesinë e përgjegjshmëritë e të qenit nënë si dhe për iniciativën e re të menaxhimit të bizneseve të saj në Zvicër së bashku me bashkëshortin. A do të rikthehet sërish të jetë pjesë e ekraneve shqiptare me një produkt të saj? Së shpejti do të kemi dasmë dhe a do të zhvillohet ajo në Shqipëri? Për më tepër në intervistën e mëposhtme.



Pamela Aliaj

Pas një shkëputjeje të gjatë, je rikthyer sërish në Shqipëri. Do të jetë për plane afatgjata?

Jo, jam kthyer në Shqipëri për të pushuar pranë njerëzve të mi të dashur, që gjatë këtij viti, në Zvicër më kanë munguar shumë. Por mbi të gjitha, që vajza ime Adia, të përshtatet edhe me klimën e Shqipërisë. Ajri i detit i bën shumë mirë.

A keni ndonjë projekt në media që prisni ta nisni në shtator. A do t'i ktheheni sërish ekranit?

Jo, projektet e mia në shtator janë në Gjenevë me bashkëshortin tim. Kemi nisur disa biznese atje, të cilat duhen menaxhuar mirë.

Keni vendosur të jetoni përfundimisht në Zvicër apo do t'i riktheheni vendlindjes?

Nuk kemi vendosur asgjë. Do të qëndrojmë në Zvicër për sa kohë ta ndjejmë se është vendi i përshtatshëm për familjen tonë. Por nuk mund të them se do jetë përgjithmonë.

Mes të qenit nënë dhe bizneswoman, si ia dilni për t'i menaxhuar të dyja?

Është e vështirë t'i balancosh mirë, në fakt, ndaj unë jam me fat që kam një dado që më ndihmon. Në të njëjtën kohë nuk bëhen dot shumë mirë të dyja. Tani po e shijoj plotësisht kohën me vajzën time dhe kur të rikthehem në Zvicër do t'i përkushtohem më shumë punës.

Tashmë jeni nënë e një vogëlusheje që ju bekoj me këtë emër. Cila është pjesa më e vështirë e rritjes së një fëmije sipas jush?

Të kuptuarit vërtet që je bërë nënë. Kjo nuk vjen menjëherë. Netët pa gjumë dhe të qararë e fëmijës kur ti nuk e kupton çfarë sikleti ka dhe nuk mundesh dot ta ndihmosh. Këto mund të them se janë një pjesë e vështirësisë. Por koha i bën gjërat më të thjeshta, ose ti thjesht fillon dhe përshtatet më shumë me rolin tënd të ri dhe kujdesi për fëmijën vjen më natyrisht.

A keni hequr dorë nga ndonjë pjesë e mënyrës së jetesës suaj për vajzën?

Sigurisht. Asgjë nuk është më njësoj. Nëse më parë mendoje vetëm për veten tënde, tani fëmija është i pari!

Së bashku me bash-



këshortin jeni celebruar por s'keni bërë ende dasmën. A keni filluar ndonjë parapërgatitje?

Kemi filluar të mendojmë dhe të diskutojmë për diçka që do na përshtatet të dyve.

Preferoni ta bëni dasmën në Shqipëri apo diku tjetër? Cila do të ishte stina më e përshtatshme për ju?

Mendoj se në Shqipëri do ta bëjmë. Në pranverë ose vjeshtë, kur të mos jetë shumë vapë.

Mes dashurisë për ekranin dhe pasionit të ri për drejtim biznesi, tek cili e shihni veten më tepër?

E shoh veten aty ku unë do të jem më e përshtatshme për të ndikuar pozitivisht. Biznesi është një fushë që kam nisur ta eksperimentoj tani, ndaj më duhet ta vazhdoj pak më gjatë për t'i parë frytet. Ndërkohë platforma që ekriani të mundëson për të ndikuar tek shikuesit do të jetë gjithnjë tërheqëse për mua.

A keni patur oferta për t'u rikthyer me një format tuajin në median Shqiptare? Cili ju ka joshur më tepër dhe mbase edhe keni pranuar?

Momentalisht nuk kam plane të rikthehem ndaj nuk vlen të diskutojmë ofertat.

Opinion i Ditës

Thaçi-Vuçiç/ Çka nëse ia dalin?

(Argumente pro marrëveshjes për të ardhmen e Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor)

Nga Baton Haxhiu

(vijnë nga faqja 1)

...më komplekse - siç duket se do të jetë marrëveshja finale ndërshtetërore mes dy vendeve, e planifikuar për vitin e ardhshëm. Kam lexuar shumë shkrime këto ditë. Hiq shkrimin e Blerim Latifit që përfaqëson idenë e qartë në shkrim, tjerat ishin jashtë kontekstit, dashakeqe dhe jokontribuese me ide të reja. Të përgendruara në fyerje dhe ndëshkime deri në tradhti. Fjalori i politikës është padyshim i vrazhdë dhe ka filluar një betejë e fortë për të shpallur tradhtarin e së ardhmes. Por, ka një lidhshmëri në Ballkan që ka hapur idenë për fundin e armiqësisë. Dhe arsyeja pse ka ndodhur ky diskutim publik mund të përfshihet në disa pika. Kemi harxhuar shumë kohë duke pritur që të tjerët t'i marrin vendimet për ne, nga frika për të vepur, të paralizuar nga ndjenja se për hir të respektit duhet të presim. Por, pritja nuk është më alternativë. Koha ka ardhur dhe kjo gjeneratë e qytetarëve të Kosovës duhet të veprojë për hir të asaj që do të vijë. Për hir të gjeneratave të ardhme të shqiptarëve. Për hir të gjeneratave të ardhme të serbëve. Për hir të gjeneratave të ardhme të europianëve.

Ne jemi gjenerata e re e Europës dhe pjesë e të ardhmes së saj, ndaj e kemi për detyrë të vepojmë në emër të vlerave të saj. Në emër të paqes, pajtimit dhe të një të ardhmeje të përbashkët.

Prandaj duhet të jemi të vendosur të japim propozime të zbatueshme në praktikë për pajtim me Serbinë dhe ta gjejmë realisht zgjidhjen për paqen e së ardhmes.

Kosova mund të bëhet shtet funksional vetëm nëse zgjidhja kërkohet në ridefinim ose delimitim të kufirit me Serbinë. Sepse, ndryshe, frika kurrë s'do ndalojë së krijuari probleme në këtë tokë.

PAK HISTORI

Tri herë veriu i Kosovës ka qenë pjesë e tavolinës për këmbim ose ridefinim të kufirit. Në kohën e kësaj përfoljeje, tema e ndarjes dhe shkëmbimit ishte tejet e gjallë dhe joshëse. Atëherë Kosova nuk ishte as pjesë e Serbisë, as pjesë e Shqipërisë dhe as pjesë e Europës. Kosova bashkonte epërsinë e popullatës shqiptare dhe epërsinë e fuqisë ushtarake serbe.

Gjatë vitit 1997, ideja e ndarjes kishte fuqinë serbe dhe prekte kufirin diku të Ferizajt. Të gjithë që banonin në Prishtinë duhej të shpërnguleshin dhe të kërkonin një hapësirë për të jetuar në një shtet që s'kishte as emër, as identitet dhe as të ardhme. Ky variant nuk përfshinte marrëveshje, por projektonte fuqinë ushtarake serbe mbi pafuqinë tonë. Kjo tablo kishte vetëm një akter dhe ata që përjetonin ndarjen pa shikuar nga prapa.

Në vitin 2000 ishte një qytet që ruante shkëlqimin e dikurshëm të bashkëjetesës. Ishte një hapësirë e territorit ku shqiptarët e Kosovës, përveç ndonjërit që



kishte prapavijë komuniste, nuk kishin shkelur kurrë në atë tokë. Ishte pjesa e veriu të Kosovës. Për pjesën tjetër të Kosovës, veriu nuk kishte asgjë të përbashkët me territorin tjetër kosovar. Pikërisht se nuk kishin dukuri të një qytetërimi të përbashkët, ata me zell mbanin veten si pjesë të një qytetërimi tjetër, por kishin edhe një dell provincializmi dhe dell për një identitet jokosovar.

Duke qenë e tillë, kjo pjesë u bë strehë e banorëve të ikur serbë që nga 13 qershori i vitit 1999. Asnjëherë - as para luftës, as pas luftës, as tash - banorët e kësaj pjesë nuk kanë qenë pjesë në jetën e qytetërimi të Kosovës. Duke qenë e tillë dhe duke e parë lehtësinë e ndarjes, forcat franceze të KFOR-it projektuan ndarjen fizike, me murin e lartë katër metra, ndarjen fizike të Veriut të Kosovës përreth lumit Ibër.

Ishte një mik francez, së bashku me ekipin e Kadri Veselit, që e pati ndaluar këtë plan duke e konsideruar veriu e Mitrovicës si pjesë të Kosovës. Muri francez nuk

u bë kurrë.

Ngjarjet e vitit 2004 shpërthyen pa fund pezmin e së kaluarës. Ky vit goditi fort idenë multietnike të Kosovës. Oliver Ivanović, një politikan pragmatik serb, duke qenë i afërt me trupat ushtarake franceze kishte kuptuar se veriu i Mitrovicës ishte vështirë i shkëputshëm nga pjesa tjetër e qytetit. Ai kishte propozuar që veriu i Kosovës ta merrte formën e vitit 1953. Konflikti dhe mosbesimi etnik kishte arritur kulmin. Serbët e veriu të Kosovës nuk dëshironin ta pranonin shtetin e Kosovës. Ivanović kishte dalë me propozim që tri komunitet serbe t'i bashkoheshin Serbisë. Kisha serbe dhe serbët brenda Kosovës kishin arritur që ta ndalin procesin me arsyetimin se për Kosovën duhet blerë kohë derisa fuqitë ndërkombëtare ta humbin interesimin për Kosovën. Dhe ashtu ndodhi.

Viti 2011 kishte lënë veriu e Kosovës jashtë interesimit të UNMIK-ut. Atje dominonte

gjihtëkça serbe. Nuk kishte asgjë që përfaqësohej nga shteti i Kosovës. Ishte një diplomat që e ndërpreu rrugën e humbjes së Veriut. Ai quhej Christopher Dell. Shprehja e tij e famshme, "Duhet ta rrotulloni tavolinën në qetësinë e restorantit për ta tërhequr vëmendjen", ishte mënyra e vetme për ta zgjuar bashkësinë ndërkombëtare, dhe sidomos Amerikën - që në një mënyrë ishin pajtuar se veriu kishte ikur - për të mos ndodhur shkëputja de facto. Dërgimi i Njësisë Speciale në veri ishte figurativisht rrotullimi i tavolinës në qetësinë e restorantit. Të gjithë u befusuan për atë se kush kishte marrë guximin që ta bënte një veprim brutal dhe ta prishte qetësinë e një fakti të kryer. Kryeministri i atëhershëm, me miratimin e kujdesshëm të ambasadorit Dell, e rikthyen temën e Veriut në bisedat me Serbinë.

Tjerat pastaj dihen. PO TASH? SHKËMBIMI ËSHTË ZGJIDHJE

Frika e fantazmave të së shkuarës,

e viktimave dhe krimeve, në emër të një mbretërie tokësore për qiejlorët. Është e pamundur ta quash "lajm të rremë" po e pagove me çiltërsi. Serbëve të Kosovës do t'iu duhen dhjetëvjeçarë që harresa të shtrihet mbi falje dhe të mund të jetojnë si fqinj të mirë me shqiptarët. Dhe ata s'kanë kohë për një gjë të tillë. Sikurse as shqiptarët nuk kanë kohë të presin që demografia të triumfojë për ta integruar pjesën veriore të tyre.

Duhet ta lëmë të ikë, në shkëmbim të integritit që mund të arrihet sot. Të integritit që do të na bënte shtet funksional dhe do të na drejtonte kah bregdeti shqiptar, kah Europa, kah e ardhmja.

PSE TANI?

Po jetojmë në një epokë të paprecedent në historinë njerëzore. Nuk ka më Lindje, por Perëndim të Largët. Turqia, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Kina janë po aq prezente në Ballkan sa edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Europian dhe Rusia. Secili me interesat dhe strategjitë e veta. Tani këto strategji mund të ndërthuren duke krijuar autostradë për të ardhmen e Kosovës.

Serbia e Aleksandar Vuçiçit, që ka mbërthyer pushtetin dhe mediat bashkë me ndjenjen populiste tek serbët, paraqet mundësi për arritje të marrëveshjes.

Aleksandar Vuçiç e projektonte të ardhmen e tij politike në të qenit një nga liderët më me peshe në rajon dhe Kosova është shtegu që mund ta konfirmojë si të tillë.

Mund të mos pëlqehet e kaluara e tij dhe fuqia e jashtëzakonshme politike aktualisht, por pikërisht këto e bëjnë atë njeriun e duhur për "ta shitur" marrëveshjen në Serbi.

Ai është shtetari që mund të arrijë akord me një tjetër po aq të tillë dhe po aq të gatshëm për akord. Kosova e ka këtë njeri, ndaj ta përdorim për të ardhmen që duam dhe meritojmë.

Çështjet e brendshme e kanë dobësuar Bashkimin Europian, që s'ka fuqi për ndonjë marrëveshje konkrete, aq më pak që atë ta shtyjë në Parlamentin Europian para zgjedhjeve të 2019-ës. Dhe fantazmat e vona të BREX-it dhe Amerikës së Trump-it janë makthe që u dalin e u tregojnë Bashkimit Europian dhe Britanisë së Madhe.

As Kosova dhe as Serbia nuk kanë kohë për të humbur. Madje nuk kanë nevojë, me liderë që janë gati ta gjejnë dhe shtrajnë rrugën drejt pajtimit. Nëse shqiptarët dhe serbët ia dalin të arrijnë marrëveshje duke lënë prapa mbrapshtinë e së shkuarës, paqja dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor mund të bëhen realitet. Në këtë rrafsh, marrëveshja do të ishte në frymën e asaj të Helsinkit dhe jo në kundërshtim me të. Paqja dhe stabiliteti janë themelet e besimit të Bashkimit Europian se në të ardhmen shqiptarët dhe serbët do të jenë qytetarë të BE-së dhe se ata do të investojnë në këtë të ardhme, për veten dhe për Europën.

Në anën tjetër, me BE-në që rrezikohet nga fryma e ringjalljes së shteteve kombe, shkëmbimi i territorëve mund të jetë i frikshëm.

Por, është shteti funksional dhe jo shteti-komb synim i këtij akordi - që do t'i shmanget një rezultati si ai në Bosnje. ➔

Dje në "Europa e lirë"

Nga teknike, në bisedime për ndryshim kufijsh

Nga Arton Konushevci

(vijon nga faqja 1)

...Thaçi dëshiron ta marrë Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin, por mos t'i japë asgjë Serbisë. E presidenti serb, Vuçiç, e ka bërë të qartë se dëshiron t'i marrë katër komuna me shumicë serbe në veri të Kosovës, por nuk ka thënë asgjë se çka do të japë si këmbim. Për kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, ndryshimi i kufijve mund të bëhet vetëm me luftë. Politologu nga Prishtina, Ramush Tahiri, thotë për Radion Evropa e Lirë, se deklaratat e tilla, mund të kuptohen se të dy presidentët janë pajtuar që të ndërrojnë tash me formatin e bisedimeve dhe të kalojnë në bisedime politike. "Qasja e dialogut dhe ndryshim i kriterëve, determinon edhe natyrën e marrëveshjes, sepse nëse flitet për korrektime të kufijve nga ana e presidentit Thaçi, ndërsa nëse flitet për që duhet Serbia ta dijë ku e ka kufirin që e kontrollon efektivisht, atëherë shihet se po bisedohet për caktimin e kufirit të ri", thotë Tahiri.

SHTETE ETNIKE

Analisti politik në Beograd, Bosko Jakšić, thotë se problemi më i madh është se nuk dihet së çfarë saktësisht nënkupton demarkacioni, duke komentuar deklaratën e presidentit serb, Aleksandar Vuçiç, për të biseduar me shqiptarët e Kosovës për çështjen e kufirit.

Ai thotë për Radion Evropa e Lirë se ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić, një vit më parë e ka përmendur çështjen e demarkacionit me Kosovën.

"Është një përpjekje për të krijuar territore etnikisht të pastra, domethënë jugu i Serbisë, që do të ishte tërësisht me serbë, dhe Kosova do të ishte etnikisht e pastër", thekson Jakšić.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar



Vuçiç, ka thënë se ai pajtohet që të ketë ridefinim të kufijve me shqiptarët. Vuçiç ka thënë se me politikën e tij angazhohet për përkufizimin e kufijve me shqiptarët.

Tahiri thekson se është vështirë të thuhet nëse të dy vendet do të mund të arrijnë një marrëveshje.

"Korrigjimi i kufijve është i mundshëm nëse të dy palët pajtohen ose siç thotë presidenti i Serbisë, për tango nevojiten dy lojtarë. Mirëpo, a do të arrihet zgjidhja, është e vështirë të thuhet, sepse konflikti serbo-shqiptar si dy kombe, është së paku që 200 vjet dhe gjithmonë kemi pasur ekspansion të vazhdueshëm të shtrirjes territoriale serbe dhe të pushteteve që janë zgjeruar në dëm të strukturës etnike dhe në dëm të territorit të popullit shqiptar", vlerëson Tahiri.

Duke folur për korrigjimin e kufirit me Serbinë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se

Kosova dhe Serbia mund ta korrigjojnë në mënyrë paqësore kufirin.

Ai me këtë rast ka përmendur përfshirjen e komunave jugore të Serbisë, Preshevë, Bujanoc e Medvegjë, në kuadër të territorit të Kosovës.

PÛRKRAHJA NDËRKOMBËTARE

Britania e Madhe dhe Gjermania kanë thënë se janë kundër ndryshimit të kufijve, sepse një gjë e tillë mund të krijojë tension dhe dhunë në rajonin e Ballkanit.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë thënë se presin një zgjidhje dhe se "Kosova dhe Serbia duhet të arrijnë një marrëveshje që është e zbatueshme, e qëndrueshme dhe nuk krijon paqëndrueshmëri në asnjërin vend apo në rajon. Kjo do të kërkojë largpamësi dhe elasticitet nga të dyja anët."

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Greg Delawie, ka

thënë se shteti i tij nuk ka ndryshuar dhe se ende vazhdon të jetë një nga mbështetësit më të mëdhenj të Kosovës dhe pavarësisë saj.

Deklaratat e ambasadorit Delawie pasojnë komentet, kryesisht të politikaneve në Beograd, se administrata e presidentit Donald Trump "nuk e mbështet pavarësinë e Kosovës", ashtu siç e kanë mbështetur ministrat e mëhershme.

"Shtetet e Bashkuara janë një nga miqtë më mbështetësit më të afërt të Kosovës, edhe pse ju mund të lexoni diçka tjetër në media, kjo nuk ka ndryshuar dhe nuk do të ndryshojë", ka thënë Delawie në Prishtinë.

"Miqësia ndërmjet dy vendeve tona është e thellë dhe është shumë dimensionale dhe ne punojmë shumë çdo ditë për t'i avancuar qëllimet tona, siç janë demokracia, siguria dhe prosperiteti", ka nënvizuar ambasadori amerikan.

← Bosnja është përkujtesë në dështimit të vendimmarrjes në Bashkimin Europian. I paralizuar nga detyrimin ndaj Marrëveshjes së Dejtonit dhe ndarjes së institucionalizuar etnike, pasojë e të parës. Të bashkuar në dështim, qytetarët e këtij shteti nuk kanë shpresë për një të ardhme më të mirë. Kjo nuk mund të jetë zgjidhje as për kosovarët, as për serbët. Ndaj kjo marrëveshje bëhet për shtet funksional, që mund të sjellë stabilitet dhe paqe në Ballkanin Perëndimor, jo për shtet-komb. Çfarëdo zgjidhje tjetër, veç shkëmbimit të territoreve, do të jetë e pamundur për t'u realizuar tani, ndërsa në të tillë skenar më së shumti do të përfitonin anarkistët dhe populistët, rrjedhimisht përmes tyre, Rusia dhe Turqia, me planet e tyre të mugëta për rajonin. Amerika, që ka për president

njeriun i cili e vlerëson akordin më shumë se gjithçka tjetër, është e gatshme të pranojë marrëveshje konkrete. Nga akordi ajo e fiton Kosovën shtet të njohur ndërkombëtarisht. E përdora fjalën "fiton", për shkak të kredos politike, ushtarake dhe morale amerikane të investuar në bërjen e këtij shteti. Për më tepër, qasja e re e SHBA-ve në raport me Europën dhe rendin botëror kërkon partnerë të rinj në rajon, ndaj llogarit në shqiptarët si një të tillë. Sepse partnerët rrisin vlerë, nuk shtojnë probleme. Dhe veçanërisht pasi me këtë marrëveshje Kosova zotohet ta respektojë sovranitetin, të vetin dhe të fqinjëve. Kjo do ta ndihmojë Maqedoninë të lëvizë me shpejtësi drejt integritimit në NATO dhe t'i ftojë elementët e të ekstremist të djathtë shqiptar. Pas Samitit të Helsinkit dhe ftesës për ta vizituar Uashingtonin,

arritja e marrëveshjeve me Putinin shihet ndryshe nga Shtëpia e Bardhë. **PO RUSIA?** Rusia është e gatshme ta përkrahë një marrëveshje që do t'i ofronte zgjidhje oportuniste të çështjeve territoriale me Ukrainën, Gjeorgjinë dhe Moldavinë. Ndaj do të ishte e gatshme ta pranonte shkëmbimin e territoreve, sepse rasti i Kosovës - që mund të konsiderohet si fitore edhe për diplomacinë amerikane - do të kthehej në precedent në ligjin dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Putin, që ka ndikim të madh në shoqërinë serbe përmes Kishës Ortodokse Serbe dhe mashave në politikë dhe në media, nuk do ta mbështesë asnjë marrëveshje nga e cila nuk fiton diçka. Nëse Rusia e pranon akordin, ai joformalisht do të pranojë edhe nga Kisha, gjë që do t'ia lehtësonte Vuçiçit ta merrte pajtimin edhe të rrymave të fuqishme nacionaliste

në Serbi. Por për të gjitha ato shtete të cilat nuk janë të qeta shkaku i tërësisë territoriale, shkëmbimi i territoreve mes Kosovës dhe Serbisë nuk paraqet brengë shtesë. Do të jetë marrëveshje pajtimi mes dy shteteve dhe jo vendim i njëanshëm. Mund ta ndihmojë Rusinë të arrijë marrëveshje për Krimenë, por vetëm si pajtim, jo si agresion. Ndaj, tash Kosova duhet të bëjë përpara kah e ardhmja që meriton. Duhet të shtyjë në atë drejtim. Tash është koha. Jo për lojëra politike. Është koha për një marrëveshje të nevojës gjeopolitike dhe Kosova duhet të zgjedhë nëse do të jetë humbëse apo fituese nga ajo. Është koha për një marrëveshje për integrim dhe ndërtim shteti. Është koha për një 'New Deal' për Kosovën! "Lapsi.al"

HOROSKOPI

DASHI

Presioni nga të moshuarit në vendin e punës dhe mosmarrëveshjet në shtëpi mund të sjellin disa stres në jetën tuaj. Kjo gjë do t'ju shpërqendronte në punë. Partneri juaj do të jenë përkrahës ndaj ideve dhe planeve tuaja të reja.

DEMI

Gjendja e mirë shëndetësore do t'ju mundësojë të merrni pjesë në aktivitete sportive. Ju do të bëni para nëse i vendosni kursimet tuaja në investime të sigurt. Armiqtë e fshehtë do të jenë të etur për të përhapur thashethemet rreth jush.

BINJAKET

Një udhëtim kënaqësie me miqtë ose anëtarët e familjes ju bën të relaksuar që të kërkon mënyra për të fituar para shtesë. Sot do të rihiqni vëmendjen e një personi të veçantë.

GAFORJA

Mos lejoni asnjëri të përfitojë nga sjellja juaj bujare. Silluni mirë me partnerin tuaj sot. Nëse këto kohë kanë qenë të lodhshme në punë, sot do të jetë një ditë më e relaksuar. Bëni kujdes me disa komentet të ashpër.

LUANI

Shëndeti juaj nuk do të jetë i përsosur sot. Një marrëveshje e re financiare do të finalizohet do ju sjellë më shumë para. Shumë dashuri do të mbizotërojë në vendin tuaj të punës sot.

VIRGJERESHA

Sot do të merrni shumë fesa interesante dhe një dhuratë surprizë mund të jetë po ashtu në rrugën tuaj. Mos bëni plane për udhëtime sepse mund të mos funksionojnë. Një lidhje dashurie nuk është në formën më të mirë.

PESHORJA

Mundohuni të dilni më shumë nga zyra dhe të bëni gjëra që me të vërtetë ju pëlqejnë. Futurat e papritura do të rrisin barrën financiare. Jeta e dashurisë do të jetë e gjallë dhe shumë aktive.

AKREPI

Do të keni kohë të mjaftueshme për të bërë gjëra, të cilat përmirësojnë shëndetin tuaj. Sot mund të fitoni shumë para, por rritja e shpenzimeve do ta bëjë të vështirë për ju që të kurseni. Nëse keni fëmijë, ata do t'ju bëjnë të ndjeheni krenarë me arritjet e tyre.

SHIGJETARI

Përpikuni të shmangni ushqimet që rrisin nivelin e kolesterolit. Mos merrni vendime të nxitura - veçanërisht kur bisedoni për çështje financiare. Një romancë do të turbullojë mendjen tuaj.

BRICJAPI

Sot mund të takoni personin që ju do më shumë se jetën e tij. Kjo gjë mund të sjellë shumë optimizëm tek ju. Edhe në çështjet e biznesit, gjërat po ecin me një ritë të mirë.

UJORI

Përpikuni të gjeni kohë dhe të relaksoheni sa më shumë që të jetë e mundur edhe në vendin e punës. Partneri juaj do të jetë përkrahës ndaj ideve dhe planeve tuaja të reja. Ju duhet të kujdeseni më shumë për pamjen tuaj fizike.

PESHQIT

Mundohuni të merrni frymë thellë dhe qetësoni trurin dhe zemrën. Eksploroni mundësi të reja investimi sot, por angazhoni veten vetëm pasi të keni studiuar qëndrueshmërinë e këtyre projekteve. Ka të ngjarë të përjetoni një lidhje dashurie.

SPECIALE

Fatmira Nikolli

Në fletëvotimet e përdorura në zgjedhjet e qeverisë Provizore të Vlorës, me shkrim dore sheh Murat Toptanin, Zihni Kaninën, Rexhep Mitrovicën, Veli Bej Klisurën, Kristo Meksin, Dhimitër Zografën, Isa Boletinin, Th.Floqin, Mustafa Krujën, Eqrem Bej Vlorën, Ilias Vrionin dhe anas tyre, votat: 55, 54, 48, etj., etj. Në të njëjtën stendë dëshmohet përmes një dokumenti edhe kontrolli i qeverisë së Vlorës mbi të huajt që hyjnë në qytet, me emra të huajsh e shqiptarësh që kanë ardhur atyre anëve në tetorin e 1913-ës.

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë kanë çelur dje të kinemaja verore ekspozitën e lëvizshme "Vlora në dokumentet e AQSh". Ekspozita përbëhet nga dokumente dhe fotografi historike të qytetit të Vlorës, deri në fund të Luftës II Botërore.

Kësodore janë ekspozuar edhe listat e nëpunësve të Prefekturës së Vlorës, ndërtesa e bashkisë para 1944-ës, ajo e prefekturës, procesverballi i zgjedhjeve të mbajtura në katundin Shushicë më 1930 dhe një tabelë me numrin e popullsisë më 1923.

Mes të tjerave, si për të dhënë jetën e banorëve të zonës ato kohë, jepet edhe dokumenti i një kërkesë për pension invaliditeti parashtruar Prefektit të Vlorës nga një veteran i Luftës së Vlorës, kërkesa e një banori të fshatit Dukat që kërkon leje gjetie, letërnjoftimi i Llazit Dhaskalit më 1925, deri edhe të spitali neuro-psikiatrik i Vlorës, lista e punonjësve të tij dhe një mandat arkitëmi i prefekturës përmes të cilit pranon dhuratën prej 25 mijë lirash(?) nga familja Vlora në dobi të spitalit shtetëror. Ka mes tyre edhe një korrespondencë të Dhomës Tregtare të Vlorës me përfaqësitë diplomatike dhe tregtare në Vlorë ku paraqiten lista emërore të tregtarëve të Vlorës si edhe llojet e mallrave që tregtojnë. Bien në sy emrat e treg-



Panorje panoramike e Ujit të Ftohtë.

Fletëvotimet e qeverisë së Vlorës dhe qyteti bardh e zi

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave nxjerr dokumentet e fotografitë



tarëve hebrej Mateto, Moise e Jozef Matathia dhe Nesim Levi.

POLICËT
Mes shumë dokumenteve veçojmë disa atë që përcakton rregullat për mbajtësit e rendit. Janë

dy nene të përkohshme të zyrës së policisë së Vlorës. Në nenin 1 thuhet se çdo profesionist teknik, ose ekspert kur ta dojë nevoja "asht i detyrurum me ju bindun urdhnavet të Policisë q'i përkasin inter-



esit moral dhe material të përgjithshëm". Në pikën "a" thuhet se kur nuk ndodhet një hoxhë a një prift i detyrurum, një hoxhë ose një prift i vendit urdhnohet me i mbarue cermontitë fetare ndaj të vdekunit dhe e njëjta gjë urdhërohet edhe për mjekët e infermierët në rast se jeta e dikujt është në rrezik.

LIBRARIA

Ekspozita përcjell edhe një katalog të librarisë "Shpresa" në Vlorë pronë e Ibrahim Shtytit si edhe një njoftim i tij, ku bën me dije se: "e përmirësuar dhe begad-uam Librarinë që kemi filluar që më 1912 me frikë e mundimë nga rebelet dhe grabitësit e huaj në

kohërat fatkeqe. Lumtësisht sot që mbusehmi me frymën e kulluarë të lirisë tonë; e kemi plotësuar me shumë lloi libra dhe rivita sa janë shtypur gjer më sot në gjuhë të tonë.

Në librarinë tonë shiten dhe gjithë gazetat shqip që dalin. Kemi dhe nga ato të vjetërat të viteve të shkuara që kur i kujtojmë nga dridhet mishtë: "Përlindja e Shqipërisë", "Populli", "Shqypja e Shqipërisë", "Rufeje", "Lirija, Shqipëri e re", "Atdheu" e të tjera dhe kuvendin e kemi. Kush e di mase i duhet njeriut nonjë numurë si nga çdo gazetë shqye le të më shkruajë mua: Vlonë, Ibrahim Shtyt


IRONIA E NDRENIKËS, E QUAN TEATRIN E RI TURBINA "MBALLOMË"

Aktori i madh i skenës shqiptare, Robert Ndrenika, duke bërë ironi për teatrin e ri "Tur-bina", të cilën e ka quajtur "mballomë", përmes një postimi në rrjetin social "Facebook" shkruan se nuk e humb shpresën e ditë më të mira do të vijin.

Duke u ndalë edhe të sherrnjaja ballkanike që po ndodh në Kosovë, Ndrenika i kërkon falje Ramush Haradinaj, ndërsa thekson se është në krah të Hashim Thaçit.

**POSTIMI I PLOTË
PRESIDENTIT TË
REPUBLIKES ZOTIT ILIR
META**

(Për dijeni të gjithë aktorëve dhe punonjësve të Teatrit)
Zoti **PRESIDENT**



Në këtë sherrnjajë ballkanike që po ndodh në Kosovë, këtu tek NE dhe gjetiu për të ashtuquajturin "ndryshim kufijsh" në fillim isha i çoroditur dhe nuk dija nga t'ia mbaja, por sot krijova bindjen dhe jam i tëri me Hashim Thaçin (të më fali Ramushi).

Në një emision televiziv konstatova se Teatri i Presheves i ndërtuar prej vitesh ishte shumë herë më i mirë se Teatri (mballomë) "Tur-bina" i ndërtuar në Tiranën e vitit 2018! Megjithatë nuk e humbas shpresën se ditë të mira më pas do të kemi!


Me plot respekt, Robert Ndrenika (aktor Teatrit në pension)



Spitali Neuro-Psikiatrik i Vlorës. Foto nga M. Baki.

Prefektura di Vlorës

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Janë llogari.
- Kufizojnë një trup.
- Janë nocionet e para.
- Janë vendet si Katari.
- Shkruajnë nga e djathta në të majtë.
- Një pjesë... dardhe.
- Janë me marka në armatura.
- Artikull spanjoll.
- Një pjesë e sadistëve.
- Janë shemra.
- Mund të jenë informacioni.
- Fillojnë javën.
- Janë gratë në Marrakesh.
- Janë dhoma.
- Një Aridian guvernator i Bankës.
- Demek s'ka kufij.
- Janë centralet si Chernobyl.
- Mbyllin një dyqan.
- Një impiant hi-fi.
- Rolet pa re.
- Një pjesë e parlamentit.

- Kufizojnë një send.
- De Filippi e Amici.
- Pagëzoi Shën Palin.
- Ushtrohet një me tryzni.
- Victorien dramaturg.
- Eshtë edhe ai i Zi.
- Fillojnë tatëpjetën.

VERTIKAL

- Hunt aktore.
- Nolde piktor.
- Gjysm siklet.
- Marsi në Areopag.
- Janë antena satelitore.
- Rrihet në fund.
- Pak tebaizëm.
- Janë taksat.
- Një test.
- Ferrara regjisor.
- Eshtë luftë.
- Kufizojnë citatet.
- Një lëndë e organizmit.
- Qureshin edhe Eumenide.
- Ai i bardhë është quajtur David Bowie.
- Eshtë si baba.
- Julia i Familja Addmas.
- Jules shkrimtar.
- Mafia pa zë.
- Role pa zë.
- Eshtë zbukurim në skenë.
- Inicialet e Morricone-s.
- Irene aktore.
- Kufij në Oslo.
- George shkrimtare.
- U shkrua nga Emile Zola.
- U shit për një tjetër zjerza.
- Film shqiptar.
- Me të nxjerrin trarë.
- Bega komik.
- Eshtë yll i skuadrës.
- Fillojnë ndeshjen.
- Satelit i Uranit.
- Inicialet e Dukas kompozitor.
- Mbarojnë fare.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Ndan kapitujt
- Emri i Gonçarov.
- Eshtë e hollë dhe therëse.
- Inicialet e Stone regjisor.
- Eshtë edhe ajo mistrat.
- Kryeqyteti i Marokut.
- Ki Moon në OKB.
- Eshtë lloj papagalli.
- Një pjesë e amerikanëve.
- Gjysmë tandem.
- Hapet me trapano.
- Një sigël maunesh.
- Ishte djali i Odiseut.
- Eshtë sherr në shtyp.
- Artikull spanjoll.
- Eshtë zog i verdhë.
- Mund të jetë kuzhine.
- Inicialet e Lattuada regjisor.
- Eshtë shtet i papës.
- Mbeten në fund.
- Pesci aktor.

VERTIKAL


- Një bukanier.
- Mosketejeri jezuit.
- Janë zërnë në lustë të tillë.
- Pak analogji.
- Gishti pa shi.
- Në radhë të parë.
- Tiriq që që tenisist.
- Tregohet nga busulla.
- Kaçaturian kompozitor.
- Fillojnë natën.
- Vallëzën me tutu.
- Janë ata që nuk kanë shumë gjak.
- Mund të jenë kursimi.
- Janë katër në violinë.
- Janë vendet e pazëna.
- Në mes të Edgar dhe Poe.
- Janë ato që në përkasin.
- Këngëtare italiane.
- Një pjesë e pavjionit.
- Braktisi Didonën.
- Munë të jenë lubrifikantë.
- Lumë në Francë.
- Kush është... do të pijë.
- Nolde piktor.
- Parashtesë zvogëluese.
- Zanore arabe.
- Rasiet pa set.
- Pak dramatike.
- Maket pa kufij.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Inicialet e Moravia-s.
- Kështu përfundin një polic.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		2						
		5	8		2	9		
	8		4	6			3	
9				7		2		6
			9		1			
	6		1					
1	7			5			4	8
2			3	4	6			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	6	5	4	2	7	9	3	8
2	9	4	8	3	5	7	1	6
7	3	8	6	9	1	2	4	5
9	2	3	7	1	6	8	5	4
4	5	6	9	8	3	1	2	7
8	1	7	5	4	2	6	9	3
5	8	9	1	6	4	3	7	2
3	7	1	2	5	8	4	6	9
6	4	2	3	7	9	5	8	1

Argëtim filozofik

- Pas një grindjeje apo një mosmarveshjeje vetjake mes një gruaje dhe një burri, nëra pale zakonisht vuan nga ideja që ka lënduar tjetrin, ndërsa tjetra vuan sidomos nga ideja se nuk e ka lënduar aq sa duhet tjetrin.
- Pas kufirit të urisë, të pasur dhe të varfër janë të njëjtë.
- Martesa është një institucion i domosdoshëm për moshën e të njëzetave, dhe i dobishëm për të tridhjetat, por jo i nevojshëm: ndërsa, për moshën më të vonë, shpesh është e dëmshme dhe përbën një kthim prapa për anën shpirtërore të burrit.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

18	3		1	6	9	8	11	8	16	4	8	D	R	I	T	A	R	E	T	B	O	T	E	
19	5	16	4	12	7	3			2		1	14	O	R	A	P	F	B	E	L	A	T		
8	I	6		3		11		8	9	6	1		B	I	K	O	L	O	N	E	L	B	I	
3	R		9	5	2	7	3	12	8	9	13	12	I	F	I	T	O	R	E	T	T	E	K	
9	K	5	2	7	3	1	4	8	15	1	4		K	O	M	E	N	T	E	T	E	L	E	
		9	6	8	12	8	9	7		6	10		H	A	R	E	M	E	R	E	S	R	A	
4	3	5	9	7		8	3	5	12	8	9	7	T	A	M	T	A	M	A	S	R	A		
3		16	1	6	4		7	15	8	4	1	6	S	A	E	D	S	T	I					
8	4	1	6	6	1		16	7		7	12	1	D	T	E	K	S	T	M	I	T	E	T	
13		6	7			11	1	7		4	1	18	E	H	R	R	I	K	I	L	O	N	I	
11	1	7		17	7	1	12		6	8	17	1	M	I	R	I	A	M	K	R	E	R	E	T
10	13	4	13	3	8	16	4	7	4		1	3	I	T	A	P	I	N	A	T	I	O		

Thënie të mençura

- Gabimi i bëri kafshët njerëz; a është në gjëndje e vërteta ta ribëjë njeriun kafshë?
- Ai që i tërbon njerëzit kundër tij, gjithnjë fiton një pjesë të tyre në anën e tij.
- Kur njeriu ulurin nga e qeshura e madhe, ua kalon të gjitha kafshëve me ultësinë e tij.
- Njerëzit janë me të ndjeshëm kur përcmohen nga të tjerët sesa kur përcmohen nga vetja e tyre.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË KALUAR

P E T E R K B A N O R E T
A M E N K B A N O R E T
R A M I T A E D E M A
P I E A N A T E M A T
R T E L E P A T I T
E K O N O M I K E R E S
K E N E T A T R O F E R T
E M R E F H R O M B I
S I N G E R I N A T I N
S A J D I T E R I T M O
S H I N E N E M I R
D A M A R I A K T E T E

FJALËKRYQI (1)

S P O T P B A A L F A
A S O P E R E T A T A S
U O P E R A T D G R A
L I P L I P O T I M I A
M O N O T O N I I R O N
L I Z T O R E T L O N
A T I A N T E U E N I
D H I T A I I L U M I S
A M A N E T A L G A T E
S T O L I K U R A T A R
P M A K E T E L E H T E

FJALËKRYQI (2)

